Udhëzuesi referencë i instaluesit

Kondicioner me ndarje ajri i montuar në mur



FTXJ20B2V1BW
FTXJ25B2V1BW
FTXJ35B2V1BW
FTXJ42B2V1BW
FTXJ50B2V1BW

FTXJ20B2V1BB
FTXJ25B2V1BB
FTXJ35B2V1BB
FTXJ42B2V1BB
FTXJ50B2V1BB

FTXJ20B2V1BS
FTXJ25B2V1BS
FTXJ35B2V1BS
FTXJ42B2V1BS
FTXJ50B2V1BS

Tabela e përmbajtjes

1 Rreth dokumentacionit 4
1.1 Kodi i produktit ... 4
1.2 Rreth këtij dokumenti ... 4
1.2.1 Kuptimi i alarmeve dhe simboleve ... 5

2 Masat paraprake të sigurisë së përgjithshme 7
2.1 Për instaluesin ... 7
2.1.1 Këshilla të përgjithshme ... 7
2.1.2 Vendi i instalimit ... 8
2.1.3 Kërkesat për hapësirën e instalimit ... 9
2.1.4 Përcaktimi i sipërfaqes minimale të dyshemesë ... 10
2.1.5 Ftohësi — në rastin e R410A ose R32 ... 11
2.1.6 Elektriket ... 13

3 Udhëzimet specifike për sigurinë e instaluesit 16

4 Rreth kutisë 18
4.1 Njësia e brendshme ... 18
4.1.1 Heqja nga paketimi i njësisë së brendshme ... 18
4.1.2 Heqja e aksesorëve nga njësia e brendshme ... 18

5 Rreth njësisë 20
5.1 Plani i sistemit ... 20
5.2 Gama e operimit ... 20
5.3 Rreth LAN-it me valë ... 21
5.3.1 Masat paraprake kur përdorni LAN-in me valë ... 21
5.3.2 Parametrat bazë ... 21
5.3.3 Rregullimi i LAN-it me valë ... 21

6 Instalimi i njësisë 23
6.1 Përgatitja e vendit të instalimit ... 23
6.1.1 Kërkesat e vendit të instalimit për njësinë e brendshme ... 23
6.2 Hapja e njësisë ... 25
6.2.1 Si të hapni panelin e përparmë ... 25
6.2.2 Heqja e panelit të përparmë ... 25
6.2.3 Si të hapni kapakun e shërbimit ... 26
6.2.4 Heqja e rrjetës së përparme ... 27
6.2.5 Heqja e kapakut të kutisë së instalimeve elektrike ... 28
6.3 Montimi i njësisë së brendshme ... 28
6.3.1 Ri-instalimi i pllakës së montimit ... 28
6.3.2 Si të shponi një vrimë në mur ... 29
6.3.3 Si të hiqni kapakun e portës së tubit ... 30
6.4 Lidhja e tubacionit të kullimit ... 31
6.4.1 Udhëzimet e përgjithshme ... 31
6.4.2 Lidhja e tubacionit në krahun e djathtë, në pjesën e pasme ose fundore djathtas ... 32
6.4.3 Lidhja e tubacionit në krahun e majtë, në pjesën e pasme ose fundore majtas ... 32
6.4.4 Kontrolli për rrjedhje uji ... 33

7 Instalimi i tubacionit 34
7.1 Përgatitja e tubacionit të ftohësit ... 34
7.1.1 Kërkesat e tubacionit të ftohësit ... 34
7.1.2 Izolimi i tubacionit të ftohësit ... 35
7.2 Lidhja e tubacionit të ftohësit ... 35
7.2.1 Lidhja e tubacionit të ftohësit me njësinë e brendshme ... 35
7.2.2 Masat paraprake kur bëhet lidhja e tubacionit të ftohësit ... 35
7.2.3 Udhëzime kur kryen lidhjen e tubacionit të ftohësit ... 36
7.2.4 Udhëzimet për përthyerjen e tubit ... 37
7.2.5 Ngjeshje e fundit të tubit ... 37
7.2.6 Lidhja e tubacionit të ftohësit me njësinë e brendshme ... 38
7.2.7 Për të kontrolluar nyjat e tubacionit të ftohësit për rrjedhje pas ngarkimit të ftohësit ... 38

8 Instalimi elektrik 40
8.1 Rreth lidhjes së instalimeve elektrike ... 40
8.1.1 Masat paraprake kur kryen lidhjet e instalimeve elektrike ... 40
8.1.2 Udhëzimet kur kryen lidhjet e instalimeve elektrike ... 41
8.1.3 Specifikimet e përbërësve standardë të instalimeve elektrike ... 43
8.2 Lidhja e instalimeve elektrike me njësinë e brendshme ... 43

8.3 Lidhja e aksesorëve opsionalë (ndërfaqja e përdoruesit të lidhur, ndërfaqja e përdoruesit qendror, etj.) 45

9 Përfundimi i instalimit të njësisë së brendshme 46

9.1 Izolimi i tubacionit të kullimit, të ftohësit dhe kabllos së ndërlidhjes 46
9.2 Kalimi i tubave ftohësit përmes vrimës së murit 46
9.3 Fiksimi i njësisë mbi pllakën e montimit 47
9.4 Mbyllja e njësisë 47
9.4.1 Ri-instalimi i rrjetës së përparme 47
9.4.2 Mbyllja e kapakut të shërbimit 47
9.4.3 Ri-instalimi i panelit të përparmë 48
9.4.4 Mbyllja e panelit të përparmë 48
9.4.5 Instalimi i kapakëve të vidhave 48

10 Vënia në punë 49

10.1 Pamja e përgjithshme: Autorizimi 49
10.2 Lista e plotë para komisionimit 49
10.3 Kryerja e një testimi 50
10.3.1 Kryerja e një testimi duke përdorur telekomandën 50

11 Konfigurimi 52

11.1 Kontakti i ndezjes/fikjes 52
11.1.1 Caktimi i kontaktit në ndezje/fikje 53

12 Kthimi te përdoruesi 55

13 Zgjidhja e problemeve 56

13.1 Zgjidhja e problemeve bazuar te kodet e gabimit 56

14 Hedhja 59

15 Të dhënat teknike 60

15.1 Skema e instalimeve elektrike 60
15.1.1 Legjenda e unifikuar e skemës së instalimeve elektrike 60

16 Fjalori 63

1 Rreth dokumentacionit

1.1 Kodi i produktit

FTXJ20B, FTXJ25B, FTXJ35B, FTXJ42B, FTXJ50B

1.2 Rreth këtij dokumenti

PARALAJMËRIM

Sigurohuni që instalimi, servisimi, mirëmbajtja, riparimi dhe materialet e përdorura ndjekin udhëzimet nga Daikin (duke përfshirë të gjitha dokumentet e renditura në "Seti i dokumentacionit") dhe, për më tepër, përputhen me legjislacionin e aplikueshëm dhe kryhen vetëm nga persona të kualifikuar. Në Evropë dhe zona ku zbatohen standardet IEC, EN/IEC 60335-2-40 është standardi i aplikueshëm.

INFORMACION

Kontrolloni që përdoruesi e ka dokumentacionin të printuar dhe kërkojini që ta mbajë për referencë në të ardhmen.

Audienca e synuar

INFORMACION

Qëllimi i kësaj pajisjeje është përdorimi nga përdoruesit ekspertë ose të trajnuar në dyqane, në industrinë e lehtë dhe ferma, ose për përdorim tregtar ose shtëpiak nga jo profesionistë.

Seti i dokumentacionit

Ky dokument është pjesë e setit të dokumentacionit. Seti i plotë përbëhet nga:

- **Masat e përgjithshme paraprake mbi sigurinë:**
  - Udhëzimet që DUHET të lexoni mbi sigurinë para instalimit
  - Formati: Skedarët digjitalë në https://www.daikin.eu. Përdorni funksionin e kërkimit 🔍 për të gjetur modelin tuaj.
- **Manuali i instalimit të njësisë së brendshme:**
  - Udhëzimet e instalimit
  - Formati: Skedarët digjitalë në https://www.daikin.eu. Përdorni funksionin e kërkimit 🔍 për të gjetur modelin tuaj.
- **Udhëzuesi referencë i instaluesit:**
  - Përgatitja e instalimit, praktikat e mira, të dhënat referencë,...
  - Formati: Skedarët digjitalë në https://www.daikin.eu. Përdorni funksionin e kërkimit 🔍 për të gjetur modelin tuaj.

Rishikimi më i fundit i dokumentacionit të dhënë botohet në faqen rajonale Daikin të internetit dhe vihet në dispozicion përmes shitësit tuaj.

Skanoni kodin QR më poshtë për të gjetur setin e dokumentacionit të plotë dhe më shumë informacion rreth produktit tuaj në uebfaqen e Daikin.

FTXJ-BB

FTXJ-BS

FTXJ-BW

Udhëzimet origjinale janë të shkruara në anglisht. Të gjitha gjuhët e tjera janë përkthime të udhëzimeve origjinale.

1.2.1 Kuptimi i alarmeve dhe simboleve

RREZIK
Tregon një situatë që rezulton në vdekje ose dëmtim të rëndë.

RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE
Tregon një situatë që mund të rezultojë në goditje elektrike.

RREZIK: RREZIK DJEGIEJE//PËRVËLIMI
Tregon një situatë që mund të rezultojë në djegie/përvëlim për shkak të temperaturave ekstreme të ngrohta ose të ftohta.

RREZIK: RREZIK SHPËRTHIMI
Tregon një situatë, që mund të rezultojë në shpërthim.

PARALAJMËRIM
Tregon një situatë që mund të rezultojë në vdekje ose dëmtim të rëndë.

KUJDES
Tregon një situatë që mund të rezultojë në dëmtim të lehtë ose të mesëm.

NJOFTIM
Tregon një situatë që mund të rezultojë në dëmtimin e pajisjeve ose të pronës.

INFORMACION
Tregon këshilla të dobishme ose informacion shtesë.

Simbolet e përdorura në njësi:

Simboli	Shpjegimi
	Para instalimit, lexoni manuali i instalimit dhe përdorimit dhe fletën e udhëzimit për lidhjet elektrike.
	Para kryerjes së detyrave të mirëmbajtjes dhe shërbimit, lexoni manualin e shërbimit.
	Për më shumë informacion, shikoni instaluesin dhe udhëzuesin referencë të përdoruesit.
	Njësia përmban pjesë rrotulluese. Bëni kujdes kur i bëni njësisë servis ose inspektim.

Simbolet e përdorura në dokumentacion:

Simboli	Shpjegimi
	Tregon një titull figure ose një referencë për të. **Shembull:** "1–3 Titulli i figurës" do të thotë "Figura 3 në kapitullin 1".

Simboli	Shpjegimi
	Tregon një titull tabele ose një referencë për të. **Shembull:** "▦ 1–3 Titulli i tabelës" do të thotë "Tabela 3 në kapitullin 1".

2 Masat paraprake të sigurisë së përgjithshme

2.1 Për instaluesin

2.1.1 Këshilla të përgjithshme

Nëse NUK jeni i sigurt si ta instaloni apo operoni njësinë, kontaktoni distributorin tuaj.



RREZIK: RREZIK DJEGIEJE//PËRVËLIMI

- MOS e prekni tubacionin e ftohësit, tubacionin e ujit apo pjesët e brendshme gjatë dhe menjëherë pas operimit. Mund të jetë shumë i nxehtë ose shumë i ftohtë. Prisni pak kohë sa të kthehet në temperaturën e zakonshme. Nëse DUHET ta prekni, mbani doreza mbrojtëse.
- MOS prekni ftohës me rrjedhje aksidentale.



PARALAJMËRIM

Instalimi i papërshtatshëm ose lidhja e pajisjeve apo aksesorëve mund të çojë në goditje elektrike, qark të shkurtër, rrjedhje, zjarr ose dëmtime të tjera ndaj pajisjes. Përdorni VETËM aksesorë, pajisje opsionale dhe pjesë këmbimi prodhuar ose miratuar nga Daikin përveç nëse specifikohet ndryshe.



PARALAJMËRIM

Sigurohu që instalimi, testimi dhe materialet e përdorura përputhen me legjislacionin në fuqi (në krye të udhëzimeve të përshkruara në dokumentacionin Daikin).



PARALAJMËRIM

Shqyeni dhe hidhni qeset plastike të paketimit në mënyrë që asnjëri, veçanërisht fëmijët, të mos luajnë me to. **Pasoja e mundshme:** mbytje.



PARALAJMËRIM

Merr masa të përshtatshme për të parandaluar që njësia të përdoret si strehë nga kafshë të vogla. Kafshët e vogla që bien në kontakt me pjesët elektrike mund të shkaktojnë ndërprerjen e funksionit, tym ose zjarr.



KUJDES

Mbaj veshur pajisje të përshtatshme mbrojtëse personale (doreza mbrojtëse, syze sigurie,...) kur kryen instalimin, mirëmbajtjen ose servisin e sistemit.



KUJDES

MOS e prek grykën hyrëse të ajrit ose fletët alumini të njësisë.



KUJDES

- MOS vendosni sende ose pajisje mbi njësinë.
- MOS u ulni, mos hipni ose mos qëndroni mbi njësinë.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, mund të kërkohet sigurimi i një regjistri bashkë me produktin që përmban të paktën: informacione për mirëmbajtjen, punë riparimi, rezultate testimesh, periudha gatishmërie,...

Të paktën gjithashtu edhe informacioni vijues DUHET të ofrohet në një vend të aksesueshëm te produkti:

- Udhëzime për fikjen e sistemit në rast urgjence
- Emri dhe adresa e zjarrfikësit, policisë dhe spitalit
- Emri, adresa dhe numrat e telefonit për ditën e natën për përdorimin e shërbimeve

Në Evropë, EN378 ofron udhëzimet e nevojshme për këtë regjistër.

2.1.2 Vendi i instalimit

- Siguro hapësirë të mjaftueshme rreth njësisë për kryerjen e servisit dhe qarkullimit të ajrit.
- Sigurohuni që vendi i instalimit e përballon peshën dhe dridhjen e njësisë.
- Sigurohu që zona të jetë e ajruar mirë. MOS blloko vrimat e ajrimit.
- Sigurohu që njësia është e niveluar.

MOS e instalo njësinë në vendet e mëposhtme:

- Në ambiente me mundësi shpërthimi.
- Në vende ku ka makineri, që lëshojnë valë elektromagnetike. Valët elektromagnetike mund të trazojnë sistemin e kontrollit dhe shkaktojnë ndërprerje të funksionit të pajisjes.
- Në vende ku ka rrezik zjarri për shkak të rrjedhjes së gazrave të djegshëm (shembull: holluesi ose benzina), fibrave të karbonit, pluhurit të ndezshëm.
- Në vende ku nxirret gaz gërryes (shembull: gazi acido sulfurik). Gërryerja e tubave të bakrit ose pjesëve të ngjitura mund të shkaktojnë rrjedhjen e ftohësit.
- Në banja.

Udhëzime për pajisjet duke përdorur ftohësin R32



ALARM: MATERIAL QË NDIZET LEHTË

Ftohësi brenda kësaj njësie digjet lehtësisht.



PARALAJMËRIM

- MOS i shpo apo digj pjesët e ciklit të ftohësit.
- MOS përdor materiale pastrimi ose mjete për të përshpejtuar procesin e heqjes së akullit ndryshe nga ato që rekomandohen nga prodhuesi.
- Ki parasysh që ftohësi brenda sistemit është pa aromë.



PARALAJMËRIM

Pajisja duhet të ruhet për të penguar dëmtimin mekanik dhe në një dhomë të ajrosur mirë pa përdorur vazhdimisht burime ndezëse (shembull: flakë të hapura, pajisje që punon me gaz ose ngrohëse elektrike) dhe përmasa e dhomës të jetë sipas specifikimit të mëposhtëm.



PARALAJMËRIM

Sigurohu që instalimi, servisi, mirëmbajtja dhe riparimi janë në përputhje me udhëzimet nga Daikin dhe me legjislacionin në fuqi (për shembull me rregullat kombëtare të përdorimit të gazit) dhe ekzekutohen VETËM nga persona të autorizuar.

PARALAJMËRIM

- Merrni masa paraprake për të shmangur dridhjet ose rrahjet e tepërta në tubacionin e ftohjes.
- Mbroni sa më shumë të jetë e mundur pajisjet e mbrojtjes, tubacionet dhe veshjet kundër efekteve negative mjedisore.
- Ofroni hapësirë për zgjerimin dhe kontraktimin e distancave të gjata të tubacionit.
- Dizajnoni dhe instaloni tubacionin në sistemet e ftohjes në atë mënyrë për të minimizuar mundësinë e tronditjeve hidraulike që dëmtojnë sistemin.
- Montoni pajisjet e brendshme dhe tubat në mënyrë të sigurt dhe ruajini për të shmangur çarjet aksidentale të pajisjeve ose tubave si për shembull nga lëvizja e mobilieve ose rikonstruktimet.

PARALAJMËRIM

Nëse një ose më shumë dhoma janë të lidhura me njësinë përmes sistemit të tubacionit, sigurohuni që:

- nuk ka burime ndezjeje në operim (shembull: flakë të hapura, pajisje gazi në operim ose ngrohës elektrik në përdorim) në rast se hapësira e katit është më pak se sipërfaqja minimale e dyshemesë A (m^2);
- nuk ka pajisje ndihmëse, që mund të jenë një burim i mundshëm ndezjeje dhe të instaluara në tubacion (shembull: sipërfaqe të nxehta me temperaturë që kalon 700°C dhe pajisje elektrike për ndërrim);
- te tubacioni përdoren vetëm pajisjet ndihmëse të miratuara nga prodhuesi;
- hyrja DHE dalja ajrit janë të lidhura direkt me të njëjtën dhomë përmes tubacionit. MOS përdorni hapësira si tavani i lëshuar si tubacion nga pjesa hyrëse ose dalëse e ajrit.

KUJDES

KURRË mos përdorni burime të mundshme ndezjeje kur kërkoni për ose zbuloni rrjedhje të ftohësit.

NJOFTIM

- MOS i përdorni sërish nyjat dhe rondelat e bakrit që janë përdorur një herë.
- Nyjat e krijuara në instalimin mes pjesëve të sistemit të ftohësit do të jenë të aksesueshme për qëllime mirëmbajtjeje.

2.1.3 Kërkesat për hapësirën e instalimit

PARALAJMËRIM

Nëse aparaturat përmbajnë ftohës R32, zona e dyshemesë së dhomës në të cilën instalohen, operohen dhe ruhen aparaturat, DUHET të jetë më e madhe se zona minimale e dyshemesë që përcaktohet në tabelën e mëposhtme A (m^2). Kjo përdoret për:

- Njësitë e brendshme **pa** një sensor për rrjedhjen e ftohësit, në rast të njësive të brendshme **me** sensor për rrjedhjen e ftohësit, referojuni manualit të instalimit
- Njësitë e instaluara jashtë ose të ruajtura brenda (p.sh. në kopshtin dimëror, garazh, dhomë makinerish)

NJOFTIM

- Tubacioni duhet të montohet në mënyrë të sigurt dhe të mbrohet nga dëmtimi fizik.
- Minimizoni sa më shumë instalimin e tubacioneve.

2.1.4 Përcaktimi i sipërfaqes minimale të dyshemesë

1 Përcakto ngarkesën totale të ftohësit në sistem (= ngarkesa e ftohësit nga fabrika ❶ + ❷ sasi shtesë ngarkuar ftohësit).



2 Përcakto grafikun ose tabelën për përdorim.

- Për njësitë e brendshme: A është njësia e fiksuar në tavan, mur apo qëndron në dysheme?
- Për njësitë e jashtme që instalohen ose ruhen brenda, kjo varet nga lartësia e instalimit:

Nëse lartësia e instalimit është…	Atëherë përdor grafikun ose tabelën për…
<1,8 m	Njësitë që qëndrojnë në dysheme
1.8≤x<2.2 m	Njësitë e fiksuara në mur
≥2.2 m	Njësitë e fiksuara në ta tavan

3 Përdorni grafikun ose tabelën për të përcaktuar zonën minimale të dyshemesë.



Ceiling-mounted unit[a]		Wall-mounted unit[b]		Floor-standing unit[c]	
m (kg)	A_{min} (m^2)	m (kg)	A_{min} (m^2)	m (kg)	A_{min} (m^2)
≤1.842	—	≤1.842	—	≤1.842	—
1.843	3.64	1.843	4.45	1.843	28.9
2.0	3.95	2.0	4.83	2.0	34.0
2.2	4.34	2.2	5.31	2.2	41.2
2.4	4.74	2.4	5.79	2.4	49.0
2.6	5.13	2.6	6.39	2.6	57.5
2.8	5.53	2.8	7.41	2.8	66.7
3.0	5.92	3.0	8.51	3.0	76.6
3.2	6.48	3.2	9.68	3.2	87.2
3.4	7.32	3.4	10.9	3.4	98.4
3.6	8.20	3.6	12.3	3.6	110
3.8	9.14	3.8	13.7	3.8	123
4.0	10.1	4.0	15.1	4.0	136
4.2	11.2	4.2	16.7	4.2	150
4.4	12.3	4.4	18.3	4.4	165
4.6	13.4	4.6	20.0	4.6	180
4.8	14.6	4.8	21.8	4.8	196
5.0	15.8	5.0	23.6	5.0	213
5.2	17.1	5.2	25.6	5.2	230
5.4	18.5	5.4	27.6	5.4	248
5.6	19.9	5.6	29.7	5.6	267
5.8	21.3	5.8	31.8	5.8	286
6.0	22.8	6.0	34.0	6.0	306
6.2	24.3	6.2	36.4	6.2	327
6.4	25.9	6.4	38.7	6.4	349
6.6	27.6	6.6	41.2	6.6	371
6.8	29.3	6.8	43.7	6.8	394
7.0	31.0	7.0	46.3	7.0	417
7.2	32.8	7.2	49.0	7.2	441
7.4	34.7	7.4	51.8	7.4	466
7.6	36.6	7.6	54.6	7.6	492
7.8	38.5	7.8	57.5	7.8	518
8	40.5	8	60.5	8	545
8.2	42.6	8.2	63.6	8.2	572
8.4	44.7	8.4	66.7	8.4	601
8.6	46.8	8.6	69.9	8.6	629
8.8	49.0	8.8	73.2	8.8	659
9	51.3	9	76.6	9	689
9.2	53.6	9.2	80.0	9.2	720
9.4	55.9	9.4	83.6	9.4	752
9.55	57.7	9.55	86.2	9.55	776

m Ngarkesa totale e ftohësit në sistem
A_{min} Sipërfaqja minimale e dyshemesë
(a) Ceiling-mounted unit (= Njësi e fiksuar në tavan)
(b) Wall-mounted unit (= Njësi e fiksuar në mur)
(c) Floor-standing unit (= Njësi që qëndron në dysheme)

2.1.5 Ftohësi — në rastin e R410A ose R32

RREZIK: RREZIK SHPËRTHIMI

Mbyllja e valvulit – Rrjedhje e ftohësit. Nëse do të mbyllësh valvulin e sistemit dhe në qarkun e ftohësit ka rrjedhje:

- MOS përdorni funksionin e mbylljes automatike të valvulit të njësisë, me të cilin ju mund të grumbulloni të gjithë ftohësin nga sistemi në njësinë e jashtme. **Pasoja e mundshme:** Vetë-djegia dhe shpërthimi i kompresorit për shkak të ajrit që hyn në kompresorin operues.
- Përdor një sistem të ndarë rikuperimi në mënyrë që kompresori i njësisë të MOS operojë.

PARALAJMËRIM

Gjatë testimeve, KURRË mos ushtro presion më të lartë se maksimumi i lejuar mbi produktin (siç tregohet në pllakën e markës së njësisë).

PARALAJMËRIM

Merr masa të mjaftueshme paraprake në rast të një rrjedhjeje të ftohësit. Nëse rrjedh gazi i ftohësit, ajros menjëherë ambientin. Rreziqet e mundshme:

- Përqendrimet e tepërta të ftohësit në një dhomë të mbyllur mund të çojnë në mungesë oksigjeni.
- Nëse gazi i ftohësit bie në kontakt me zjarrin, mund të prodhohet gaz toksik.

PARALAJMËRIM

GJITHMONË kthejeni ftohësin në gjendje normale. MOS e lëshoni direkt në mjedis. Përdorni një pompë vakumi për të hequr instalimin.

PARALAJMËRIM

Kontrolloni që në sistem nuk ka oksigjen. Ftohësi mund të ngarkohet VETËM pas kryerjes së testimit të rrjedhjes dhe tharjes me vakum.

Pasoja e mundshme: Vetë-djegie dhe shpërthim i kompresorit për shkak se oksigjeni depërton në kompresorin e operimit.

NJOFTIM

- Për të shmangur avarinë e kompresorit, MOS e ngarkoni më shumë se sasinë e specifikuar të ftohësit.
- Kur hapet sistemi i ftohësit, ai DUHET të menaxhohet në përputhje me legjislacionin në zbatim.

NJOFTIM

Sigurohu që instalimi i tubacionit të ftohësit përputhet me legjislacionin në fuqi. Në Evropë, EN378 është standardi që zbatohet.

NJOFTIM

Sigurohuni që tubacioni në ambient të hapur dhe lidhjet të MOS i nënshtrohen tensionit.

NJOFTIM

Pas lidhjes të të gjithë tubacionit, sigurohu që nuk ka rrjedhje gazi. Përdor nitrogjen për të kapur rrjedhjen e gazit.

- Në rast se duhet një ringarkim, referoju pllakës të njësisë ose etiketësë së ngarkimit të ftohësit të njësisë. Ajo konstaton llojin e ftohësit dhe sasinë e nevojshme.
- Qoftë kur njësia është e ngarkuar me ftohës ose jo që nga dalja nga fabrika, në të dy rastet mund t'ju duhet të ngarkoni ftohës shtesë, në varësi të madhësive dhe gjatësive të tubave të sistemit.
- Përdor vegla ekskluzive VETËM për llojin e ftohësit të përdorur në sistem, për të siguruar rezistencën e presionit dhe për të parandaluar hyrjen e materialeve të huaja brenda në sistem.
- Ngarko ftohësin e lëngshëm si në vazhdim:

Nëse	Atëherë
Ka prani të një tub sifoni (d.m.th. cilindri është i shënuar "Ngjitur gjendet sifoni që mbushet me lëng")	Ngarko me cilindrin në pozicion vertikal. 
Nuk ka prani të tubit të sifonit	Ngarko me cilindrin përmbys. 

- Hapi cilindrat e ftohësit ngadalë.
- Ngarkoje ftohësin në formë të lëngshme. Shtimi tij në formë të gaztë mund të parandalojë përdorimin normal.

KUJDES

Kur kryhet procedura e ngarkimit të ftohësit ose kur ndërpritet, mbyllni menjëherë valvulin e enës së ftohësit. Nëse valvuli NUK mbyllet menjëherë, presioni i mbetur mund të ngarkojë ftohës shtesë. **Pasoja e mundshme:** Sasi e pasaktë e ftohësit.

2.1.6 Elektriket

RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE

- FIKNI të gjithë furnizimin me energji elektrike para se të heqësh kapakun e kutisë së çelësit, duke lidhur instalimet elektrike ose duke prekur pjesët elektrike.
- Shkëputni furnizimin me energji elektrike për më shumë se 10 minutave dhe matni voltazhin te terminalet e kondensatorëve të qarkut kryesor ose përbërësve elektrikë para shërbimit. Voltazhi DUHET të jetë më i vogël se 50 V DC para se të prekni përbërësit elektrikë. Për vendndodhjen e terminaleve, shikoni skemën e instalimeve elektrike.
- MOS i prek përbërësit elektrikë me duar të lagura.
- MOS e lër njësinë të pambikëqyrur kur hiqet kapaku i servisit.

PARALAJMËRIM

Nëse NUK instalohet që në fabrikë, një çelës kryesor ose mjete të tjera për shkëputje, duke pasur një ndarje kontakti në të gjitha shtyllat që ofrojnë shkëputje të plotë në gjendjen e kategorisë III të mbitensionit, DUHEN instaluar tek instalimet elektrike.

PARALAJMËRIM

- Përdorni VETËM tela bakri.
- Sigurohuni që instalimet elektrike në terren të përputhen me rregulloret kombëtare të instalimeve.
- Të gjitha instalimet elektrike në terren DUHET të kryhen në përputhje me diagramin e instalimeve elektrike të furnizuar me produktin.
- KURRË MOS i ngjishni kabllot e paketuara dhe sigurohuni që TË MOS bien në kontakt me tubacionet dhe skajet e mprehta. Sigurohuni që asnjë presion i jashtëm të mos ushtrohet në lidhjet e kontakteve.
- Sigurohuni që të instaloni linjën e tokëzimit. MOS e tokëzoni njësinë në tuba shërbimi, absorbues mbitensioni apo tokëzime telefonike. Tokëzimi i paplotë ose i gabuar mund të shkaktojë goditje elektrike.
- Sigurohuni të përdorni qark të dedikuar elektrik. Mos përdorni ushqim elektrik të ndarë me pajisje tjetër.
- Sigurohuni të instaloni siguresat ose automatët e kërkuar.
- Sigurohuni të instaloni automat mbrojtës me shkarkim tokëzimi. Përndryshe mund të ndodhin goditje elektrike ose zjarr.
- Kur instaloni automat mbrojtës me shkarkim tokëzimi, sigurohuni që të pajtohet me inverterin (rezistent ndaj zhurmës elektrike me frekuencë të lartë) për të shmangur hapjen e panevojshme të automatit mbrojtës me shkarkim tokëzimi.

PARALAJMËRIM

- Pas përfundimit të instalimeve elektrike, konfirmoni që secili komponent elektrik dhe terminal brenda kutisë së ndërrimit është i lidhur në mënyrë të sigurt.
- Sigurohu që të gjithë kapakët të jenë të mbyllur para se të ndezësh njësinë.

KUJDES

- Kur lidhni energjinë: së pari bëni lidhjen e kabllos së tokëzimit para se të kryeni lidhjet që mbartin rrymën.
- Kur ndërpritni furnizimin me energji: së pari bëni ndërprerjen e kabllove që mbartin rrymën para se të kryeni ndarjen e lidhjes së tokëzimit.
- Gjatësia e përcjellësve mes çlirimit të presionit të energjisë dhe vetë bllokut të terminalit DUHET të jetë e atillë që telat që mbartin rrymë janë të tendosur para telit të tokëzimit në rast se korrenti lirohet nga çlirimi i presionit.

NJOFTIM

Masat paraprake kur kryeni instalimet elektrike:



- MOS i lidhni instalimet me trashësi të ndryshme me bllokun e terminalit të energjisë (xhokoja në instalime mund të shkaktojë nxehtësi anormale).
- Kur lidhni instalimet elektrike që kanë të njëjtën trashësi, veproni siç tregohet në figurën e mësipërme.
- Për instalimet, përdorni telin e përcaktuar të korrentit dhe lidhni fort, pastaj siguroni për të parandaluar ushtrimin e presionit në bordin e terminalit.
- Përdorni një kaçavidë të përshtatshme për shtrëngimin e vidhave terminale. Një kaçavidë me kokë të vogël e dëmton kokën dhe e bën shtrëngimin të pamundur.
- Shtrëngimi më tepër se duhet i vidhave terminale mund t'i thyejë ato.

Instaloni kabllo energjie të paktën 1 metër larg televizorëve ose radiove për të penguar interferencën. Në varësi të valëve të radios, distanca prej 3 metrave mund të MOS jetë e mjaftueshme.

NJOFTIM

Zbatohet VETËM nëse furnizimi me energji elektrike është me tre faza, dhe kompresori ka një metodë fillimi me NDEZJE/FIKJE.

Nëse ekziston mundësia e fazës së kthimit pas një bllokimi momental dhe energjia NDIZET dhe FIKET kur produkti është në përdorim, ngjit lokalisht një qark mbrojtës të fazës së kthimit. Vënia në punë e produktit në fazën e kthimit mund të thyejë kompresorin dhe pjesë të tjera.

3 Udhëzimet specifike për sigurinë e instaluesit

Zbatoni gjithmonë udhëzimet për sigurinë dhe rregullat vijuese.

Instalimi i njësisë (shihni "6 Instalimi i njësisë" [▸ 23])

PARALAJMËRIM

Instalimi duhet të kryhet nga një instalues, zgjedhja e materialeve dhe instalimi duhet të përputhet me legjislacionit e zbatueshëm. Në Evropë, EN378 është standardi i zbatueshëm.

PARALAJMËRIM

Pajisja duhet të ruhet për të parandaluar dëmtimin mekanik dhe në një dhomë të ajrosur mirë pa burime ndezjeje që janë vazhdimisht në gjendje pune (p.sh. flakë të hapura, pajisje gazi në gjendje pune ose një ngrohës elektrik po në gjendje pune). Madhësia e dhomës duhet të jetë siç specifikohet në masat e përgjithshme paraprake mbi sigurinë.

KUJDES

Për muret që përmbajnë një kornizë ose dërrasë metalike, përdorni një tub të futur në mur dhe veshje muri te mekanizmi i furnizimit përmes vrimës për të parandaluar një nxehtësi të mundshme, shok elektrik apo zjarr.

Instalimi i tubacionit (shihni "7 Instalimi i tubacionit" [▸ 34])

A2L

ALARM: MATERIAL QË NDIZET LEHTË

Ftohësi brenda kësaj njësie digjet lehtësisht.

KUJDES

Tubacioni dhe nyjat e bashkimit të një sistemi të ndarë do të kryhen me nyja të përhershme kur të jenë brenda një hapësire të zënë përveç nyjave që lidhin tubacionin me njësitë e brendshme.

RREZIK: RREZIK DJEGIEJE//PËRVËLIMI

KUJDES

- Ngjeshja e paplotë mund të shkaktojë rrjedhje të gazit të ftohësit.
- MOS ripërdorni ngjeshje. Përdor ngjeshje të reja për të parandaluar rrjedhjen e gazit të ftohësit.
- Përdorni dado ngjeshëse që përfshihen me njësinë. Përdorimi i dadove të ndryshme ngjeshëse mund të shkaktojë rrjedhjen e gazit të ftohësit.

Instalimi elektrik (shihni "8 Instalimi elektrik" [▸ 40])

RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE

PARALAJMËRIM

GJITHMONË përdor kabllo me shumë bërthama për kabllot e furnizimit me energji elektrike.

PARALAJMËRIM

- Të gjitha instalimet elektrike DUHEN kryer nga një elektricist i autorizuar dhe DUHET të pajtohen me rregulloren kombëtare të instalimeve elektrike.
- Kryeni lidhjet elektrike tek instalimet e montuara.
- Të gjithë komponentët e prokuruar në vend dhe të gjitha punimet elektrike DUHET të përputhen me legjislacionin në fuqi.

PARALAJMËRIM

- Nëse furnizimit me energji elektrike i mungon faza-N ose është e gabuar, pajisja mund të prishet.
- Vendos tokëzimin e duhur. MOS e tokëzoni njësinë te tubat e shërbimeve utilitare, përthithësi i fryrjeve apo tokëzimet e telefonit. Tokëzimi i paplotë mund të shkaktojë goditje elektrike.
- Instalo siguresat e kërkuara ose siguresat e qarkut.
- Siguroji instalimet elektrike me lidhëse kabllosh që kabllot të mos bin në kontakt me tehet e mprehta apo tubacionin, veçanërisht në anën e presionit të lartë.
- MOS e instaloni kondensatorin për përparimin e fazës, sepse kjo pajisje është e pajisur me një inverter. Kondensatori për përparimin e fazës ul performancën dhe mund të shkaktojë aksidente.

PARALAJMËRIM

MOS e zgjatni kabllon e korrentit ose të ndërlidhjes duke përdorur lidhës telash, kapëse telash, tela me ngjitëse, zgjatues.

Këta mund të shkaktojnë mbinxehje, goditje elektrike ose zjarr.

PARALAJMËRIM

Përdorni një lloj çelësi për ndërprerje me të gjitha polet me të paktën 3 mm mes hapësirave të pikës së kontaktit që ofron ndërprerje të plotë sipas kategorisë III të mbitensionit.

PARALAJMËRIM

Nëse kordoni i korrentit është i dëmtuar, DUHET të ndërrohet nga prodhuesi, agjenti i shërbimit ose persona të ngjashëm të kualifikuar për të shmangur një rrezik.

PARALAJMËRIM

MOS e lidhni furnizimin e energjisë me njësinë e brendshme. Kjo mund të rezultojë në shok elektrik ose zjarr.

PARALAJMËRIM

- MOS përdorni pjesë elektrike të blera lokalisht brenda produktit.
- MOS e degëzoni furnizimin me energji elektrike për pompën e kullimit, etj. nga blloku terminal. Kjo mund të rezultojë në shok elektrik ose zjarr.

PARALAJMËRIM

Sistemin e instalimit të ndërlidhjes mbajeni larg tubave të bakrit pa izolim termal, sepse mund të jenë shumë të nxehta.

4 Rreth kutisë

Mbani këto parasysh:

- Njësia DUHET të kontrollohet për dëmtime dhe plotësi gjatë dorëzimit. Çdo dëmtim ose pjesë që mungon DUHET t'i raportohet menjëherë agjentit të ankesave të operatorit.
- Sill njësinë e paketuar sa më afër të jetë e mundur te pozicioni final i instalimit për të parandaluar dëmtimin gjatë transportimit.
- Përgatitni paraprakisht rrugën gjatë të cilës dëshironi të sillni njësinë në pozicionin e saj përfundimtar të instalimit.
- Kur merrni në përdorim njësinë, merrni parasysh këto:

  E brishtë, përdoreni njësinë me kujdes.

  Mbajeni njësinë vertikalisht për të shmangur dëmtimin.

4.1 Njësia e brendshme

4.1.1 Heqja nga paketimi i njësisë së brendshme



4.1.2 Heqja e aksesorëve nga njësia e brendshme

1 Hiqni:

- qesen e aksesorëve që gjendet në fund të paketimit,
- pllakën e montimit bashkëngjitur pjesës së pasme të njësisë së brendshme,
- ngjitësen rezervë SSID që gjendet në grilën para.



a Manuali i përdorimit
b Filtri aromatizues i apatitit prej titani dhe filtri argjend i pastrimit (filtri Ag-ion)
c Vidha e montimit të njësisë së brendshme (M4×12L). Referojuni "9.3 Fiksimi i njësisë mbi pllakën e montimit" [▸ 47].
d Bateri e thatë AAA.LR03 (alkali) për telekomandën
e Telekomanda uajrles (ndërfaqja e përdoruesit)
f Pllaka e montimit

g Kapaku i vidës
h Ngjitëse rezervë SSID me letër lëshimi (ngjitur me njësinë)

- **Ngjitëse rezervë SSID.** MOS e hidhni ngjitësen rezervë. Mbajeni në një vend të sigurt në rast se ju nevojitet në të ardhmen (p.sh. në rast se ndërrohet rrjeta para ngjiteni te rrjeta e re).

5 Rreth njësisë

A2L

ALARM: MATERIAL QË NDIZET LEHTË

Ftohësi brenda kësaj njësie digjet lehtësisht.

5.1 Plani i sistemit



a Paneli i përparmë
b Filtri i ajrit
c Kapaku i shërbimit
d Ngjitëse SSID
e Sensori inteligjent i syve
f Syri Daikin
g Stukoni hapësirën e vrimës së tubit
h Filtri aromatizues i apatitit prej titani dhe filtri argjend i pastrimit (filtri Ag-ion)
i Tubacioni i ftohësit, zorra e kullimit dhe kablloja e ndërlidhjes
j Izolant
k Telekomanda uajrles (ndërfaqja e përdoruesit)

5.2 Gama e operimit

Përdore sistemin në kufijtë vijues të temperaturës dhe lagështisë për përdorim të sigurt dhe të efektshëm.

	Ftohje dhe tharje[a][b]	**Ngrohja[a]**
Temperatura jashtë për modelet RXJ	–10~50°C DB	–20~24°C DB –21~18°C WB
Temperatura jashtë për modelet 2MXM, 3MXM, 4MXM, 5MXM	–10~46°C DB	–15~24°C DB –15~18°C WB
Temperatura brenda	18~37°C DB 14~28°C WB	10~30°C DB
Lagështia e brendshme	≤80%[a]	—

[a] Një pajisje sigurie mund ta ndalojë operimin e sistemit nëse njësia punon jashtë gamës së operimit.
[b] Kondensimi dhe pikimi i ujit mund të ndodhë nëse njësia punon jashtë gamës së operimit.

5.3 Rreth LAN-it me valë

Për specifikimet e detajuara, udhëzimet e instalimit, metodat e cilësimit, pyetjet e shpeshta FAQ, deklaratën e pajtueshmërisë dhe versionin e fundit të këtij manuali, vizitoni app.daikineurope.com.

INFORMACION: Deklarata e pajtueshmërisë

Daikin Industries Czech Republic s.r.o. deklaron se lloji i pajisjes së radios brenda kësaj njësie është në pajtim me Direktivën 2014/53/EU.

5.3.1 Masat paraprake kur përdorni LAN-in me valë

MOS e përdorni afër:

- **Pajisjeve mjekësore.** P.sh. personave që përdorin stimulues kardiakë ose defibrilatorë. Ky produkt mund të shkaktojë interferencë elektromagnetike.
- **Pajisjeve me kontroll automatik.** P.sh. dyerve automatike ose pajisjeve të alarmit të zjarrit. Ky produkt mund të shkaktojë defekte të pajisjes.
- **Mikrovalës.** Mund të ndikojë te komunikimet uajrles LAN.

5.3.2 Parametrat bazë

Çfarë	Vlera
Fusha e frekuencës	2400 MHz~2483.5 MHz
Protokolli i radios	IEEE 802.11b/g/n
Kanali i frekuencës së radios	1~13
Energjia output	13 dBm
Energjia efektive e rrezatuar	15 dBm (11b) / 14 dBm (11g) / 14 dBm (11n)
Furnizimi me energji	DC 14 V / 100 mA

5.3.3 Rregullimi i LAN-it me valë

Klienti mban përgjegjësi për të ofruar:

- Telefon inteligjent ose tablet me versionin minimal të mbështetur të Android ose iOS, përcaktuar në app.daikineurope.com
- Linjë interneti dhe pajisje komunikimi si modem, ruter etj.
- Pikë aksesi linje LAN uajrles.
- Aplikacion falas ONECTA të instaluar.

Instalimi i aplikacionit ONECTA

1. Shkoni te Google Play (për pajisjet Android) ose App Store (për pajisjet iOS) dhe kërkoni "ONECTA".
2. Ndiqni udhëzimet në ekran për të instaluar aplikacionin ONECTA.

Kërkoni direkt aplikacionin duke përdorur QR në ekranin e telekomandës uajrles

1 Hyni në menynë kryesore duke shtypur ··· dhe navigoni për te menyja e cilësimit të telekomandës uajrles duke përdorur < dhe >.

2 Shtypni ✓ për të hyrë në meny.

Menyja e cilësimit të kontrollit të telekomandës



3 Navigoni për tek ekrani i kodit të QR duke përdorur < dhe >.

4 Skanoni kodin QR me telefonin tuaj inteligjent ose pajisjet e tjera inteligjente.

Rezultati: Kodi QR do t'ju ridrejtojë te App Store ose Google Play.



5 Ndiqni udhëzimet në ekran për instalim.

INFORMACION

Nëse kodi QR është i vështirë për t'u lexuar, ndërroni kodin QR duke përdorur ^ ose v, pastaj provoni sërish.

6 Instalimi i njësisë

PARALAJMËRIM

Instalimi duhet të kryhet nga një instalues, zgjedhja e materialeve dhe instalimi duhet të përputhet me legjislacionit e zbatueshëm. Në Evropë, EN378 është standardi i zbatueshëm.

Në këtë kapitull

6.1 Përgatitja e vendit të instalimit 23
6.1.1 Kërkesat e vendit të instalimit për njësinë e brendshme 23
6.2 Hapja e njësisë 25
6.2.1 Si të hapni panelin e përparmë 25
6.2.2 Heqja e panelit të përparmë 25
6.2.3 Si të hapni kapakun e shërbimit 26
6.2.4 Heqja e rrjetës së përparme 27
6.2.5 Heqja e kapakut të kutisë së instalimeve elektrike 28
6.3 Montimi i njësisë së brendshme 28
6.3.1 Ri-instalimi i pllakës së montimit 28
6.3.2 Si të shponi një vrimë në mur 29
6.3.3 Si të hiqni kapakun e portës së tubit 30
6.4 Lidhja e tubacionit të kullimit 31
6.4.1 Udhëzimet e përgjithshme 31
6.4.2 Lidhja e tubacionit në krahun e djathtë, në pjesën e pasme ose fundore djathtas 32
6.4.3 Lidhja e tubacionit në krahun e majtë, në pjesën e pasme ose fundore majtas 32
6.4.4 Kontrolli për rrjedhje uji 33

6.1 Përgatitja e vendit të instalimit

PARALAJMËRIM

Pajisja duhet të ruhet për të parandaluar dëmtimin mekanik dhe në një dhomë të ajrosur mirë pa burime ndezjeje që janë vazhdimisht në gjendje pune (p.sh. flakë të hapura, pajisje gazi në gjendje pune ose një ngrohës elektrik po në gjendje pune). Madhësia e dhomës duhet të jetë siç specifikohet në masat e përgjithshme paraprake mbi sigurinë.

Zgjidhni një vend instalimi me hapësirë të mjaftueshme për të bërë transportimin e njësisë në dhe jashtë kantierit.

MOS e instaloni njësinë në vende që shpesh përdoren si vend pune. Në rast punimesh (p.sh. mprehje) ku krijohet shumë pluhur, njësia DUHET mbuluar.

6.1.1 Kërkesat e vendit të instalimit për njësinë e brendshme

INFORMACION

Lexoni gjithashtu masat paraprake dhe kërkesat në "2 Masat paraprake të sigurisë së përgjithshme" [▶ 7].

INFORMACION

Niveli i presionit të zërit është më pak se 70 dBA.

- **Rryma e ajrit.** Sigurohu që asgjë të mos bllokojë rrymën e ajrit.
- **Kullimi.** Sigurohu që uji i kondensuar mund të hiqet siç duhet.
- Izolimi i murit. Kur kushtet në mur kalojnë 30°C dhe kur në mur vendoset një lagështi relative prej 80% ose ajër i freskët, atëherë kërkohet izolimi shtesë (minimumi 10 mm trashësi, sfungjer polietileni).

- **Forca e murit.** Kontrolloni nëse muri është mjaftueshëm i fortë për të mbajtur peshën e njësisë. Nëse ka rrezik, përforconi mur para instalimit të njësisë.

Instaloni kabllo energjie të paktën 1 metër larg televizorëve ose radiove për të penguar interferencën. Në varësi të valëve të radios, distanca prej 3 metrave mund të MOS jetë e mjaftueshme.

- Zgjidh një vendndodhje ku zhurma e ajrit ose ajri i nxehtë/ftohtë çlirohet nga njësia nuk shqetëson askënd dhe vendndodhja zgjidhet sipas legjislacionit në fuqi.
- Drita fluoreshente. Kur instaloni një telekomandë uajrles (ndërfaqja e përdoruesit) në një dhomë me drita fluoreshente, mbani parasysh të mëposhtme për të shmangur interferencën:
  - Instaloni telekomandën uajrles (ndërfaqja e përdoruesit) sa më afër me njësinë e brendshme të jetë e mundur.
  - Instaloje njësinë e brendshme sa më larg të jetë e mundur me dritat fluoreshente.

NUK rekomandohet instalimi i njësisë në vendet vijuese, sepse mund të shkurtojnë jetëgjatësinë e njësisë:

- Aty ku voltazhi luhatet shumë
- Në automjete ose mjete lundrimi
- Aty ku ka prani të avullit acidik ose alkalik
- Në vende ku në atmosferë ka prani piklash prej vaji mineralesh, spërka ose avull. Pjesët plastike mund të përkeqësohen dhe të bien ose mund të shkaktojnë rrjedhje uji.
- Në vendet ku njësia do të bllokonte rrezet e drejtpërdrejta të diellit.
- Në banja.
- Zonat e ndjeshme ndaj zërit (p.sh. afër një dhome gjumi), në mënyrë që zhurma e operimit të mos shkaktojë shqetësime.

NJOFTIM

MOS vendosni sende poshtë njësisë së brendshme dhe/ose të jashtme që mund të njomet. Përndryshe kondensimi te njësia kryesore ose tubat e ftohësit, pisllëku i ajrit të filtrit ose bllokimi i drenazhit mund të shkaktojë pikim dhe sendet poshtë njësisë mund të bëhen pis ose dëmtohen.

- **Hapësira.** Instaloni njësinë të paktën 1,8 m nga dyshemeja dhe mbani parasysh këto kërkesa për distancat nga muret dhe tavani:



Shënim: Sigurohuni që të mos ketë pengesa brenda 500 mm poshtë marrësit të sinjalit infrakuq. Ato mund të ndikojnë në performancën e marrjes të telekomandës.

6.2 Hapja e njësisë

6.2.1 Si të hapni panelin e përparmë

1 Mbani panelin e përparmë në të dy anët dhe tërhiqeni lart me kujdes derisa të arrijë pozicionin kufi.



2 Ulni poshtë të dy kyçet në pjesën e pasme të panelit të përparmë.

3 Hapni panelin e përparmë derisa mbështetësja të përshtatet te skeda e montimit.



a Kyçi (1 në secilën krah)
b Ana e pasme e panelit të përparmë
c Skeda e montimit
d Mbështetje

6.2.2 Heqja e panelit të përparmë

> **INFORMACION**
> Hiqni panelin e përparmë vetëm në rast se DUHET të ndërrohet.

1 Hapni panelin e përparmë. Shikoni "6.2.1 Si të hapni panelin e përparmë" [▸ 25].

2 Hapni kyçet e panelit në pjesën e pasme e panelit (1 në secilën anë).



a Kyçi i panelit

3 Shtyni ngadalë krahun e djathtë nga e djathta për të shkëputur boshtin nga sloti i tij po në këtë krah.



a Krahu
b Sloti i boshtit
c Boshti

4 Shkëputni boshtin e panelit të përparmë nga sloti i boshtiut në anën e majtë.



a Krahu
b Sloti i boshtit
c Boshti

5 Hiqni panelin e përparmë.

6 Për të riinstaluar panelin e përparmë, kryeni hapat sipas rregullit të kundërt.

6.2.3 Si të hapni kapakun e shërbimit

1 Hiqni 1 vidhë nga kapaku i shërbimit.

2 Tërhiqni horizontalisht kapakun e shërbimit nga njësia.



a Kapaku i shërbimit
b Vidha e kapakut të shërbimit

NJOFTIM

Kur mbyllni kapakun e shërbimit, sigurohuni që çifti rrotullues i shtrëngimit NUK e kalon 1.4 (±0.2) N•m.

6.2.4 Heqja e rrjetës së përparme

KUJDES

Mbaj veshur pajisje të përshtatshme mbrojtëse personale (doreza mbrojtëse, syze sigurie,...) kur kryen instalimin, mirëmbajtjen ose servisin e sistemit.

1. Hapni panelin e përparmë. Referojuni "6.2.1 Si të hapni panelin e përparmë" [▸ 25].
2. Hiqni kapakun e shërbimit. Referojuni "6.2.3 Si të hapni kapakun e shërbimit" [▸ 26].
3. Hiqni rripin e telit nga morseta e telit, shkëputni lidhësin dhe vendoseni në mbajtësen e lidhësit.
4. Poziciononi me kujdes fllanxhën me dorë që të mos kapet gjatë heqjes së rrjetës së përparme.
5. Nëse është e instaluar, hiqni 2 kapakët e vidhave duke përdorur një pllakë të gjatë të sheshtë si një vizore e mbështjellë në një leckë dhe hiqni 2 vidhat.



a Lidhësi
b Kapësja e telit

6. Shtyjeni lart rrjetën e përparme dhe pastaj drejt pllakës së montimit për ta hequr rrjetën nga 3 grremçat.



a Grremçi

Kushti paraprak: Nëse vendi i punës është i kufizuar.

7. Futni me rrëshqitje kaçavidën minus në drejtim të trekëndëshit në hulli në dhëmbëzën gjysmë-hënë në rrjetë.



a Simboli i trekëndëshit

8 Shtypni ngadalë për poshtë rrjetën e përparme dhe futni kaçavidën në vrimën ngjitur me grremçat.

9 Tërhiqni rrjetën e përparme lart duke përdorur një kaçavidë minus dhe tërhiqeni drejt anës para.



a Vrima
b Dhëmbëz në formë gjysmë-hëne

6.2.5 Heqja e kapakut të kutisë së instalimeve elektrike

Kushti paraprak: Hiqni rrjetën e përparme.

1 Hiqni 1 vidhë nga kutia e instalimeve elektrike.

2 Hapni kapakun e kutisë së instalimeve elektrike duke e tërhequr drejt pjesës para.

3 Hapni kapakun e kutisë së instalimeve elektrike nga 2 grremçat e pasmë.



a Vida
b Kapaku i kutisë së instalimeve elektrike
c Grremçi i pasmë

4 Për të rivendosur kapakun, së parë bashkëngjitni kutinë e instalimeve elektrike me grremçat, mbylleni atë dhe rivendosni vidhën.

NJOFTIM
Kur mbyllni kapakun e kutisë së instalimeve elektrike, sigurohuni që çifti rrotullues i shtrëngimit NUK e kalon 2.0 (±0.2) N•m.

6.3 Montimi i njësisë së brendshme

Në këtë kapitull

6.3.1 Ri-instalimi i pllakës së montimit 28
6.3.2 Si të shponi një vrimë në mur 29
6.3.3 Si të hiqni kapakun e portës së tubit 30

6.3.1 Ri-instalimi i pllakës së montimit

1 Instalimi i përkohshëm i pllakës së montimit.

2 Niveloni pllakën e montimit.

3 Shënoni qendrat e pikave të shpimit në mur duke përdorur një matës. Vendoseni metrin matës te simboli "▷".

4 Mbaroni instalimin duke siguruar pllakën e montimit në mur duke përdorur vidha M4×25L (furnizuar nga klienti).

INFORMACION

Kapaku i portës së tubit të hequr mund të mbahet në një xhep të pllakës së montimit.





a Pikat e fiksimit të pllakës së montimit të rekomanduar
b Xhep për kapakun e portës së tubit
c Fundi i tubit të lëngjeve
d Fundi i tubit të gazrave
e Përdorni matës siç tregohet
f Mbajtëset për vendosjen e një niveluesi
g Qendra e njësisë
h Vrima për tubacionin e montuar Ø65 mm
i1 Qendra e vrimës së tubacionit është 155 mm në të majtë
i2 Qendra e vrimës së tubacionit është 150 mm në të djathtë
j Pozicioni për metrin te simboli "▷"
k Gjatësia e tubacionit të gazrave
l Gjatësia e tubacionit të lëngjeve
m Gjatësia e zorrës së kullimit
n Konturi i njësisë
o Konturi i pjesës së pasme të njësisë

6.3.2 Si të shponi një vrimë në mur

KUJDES

Për muret që përmbajnë një kornizë ose dërrasë metalike, përdorni një tub të futur në mur dhe veshje muri te mekanizmi i furnizimit përmes vrimës për të parandaluar një nxehtësi të mundshme, shok elektrik apo zjarr.

NJOFTIM

Sigurohuni të izoloni boshllëqet përreth tubave me material izolues (siguruar nga instaluesi) për të parandaluar rrjedhjen e ujit.

1. Hapni një mekanizëm furnizimi 65 mm të madh përmes vrimës në mur me një pjerrësi tatëpjetë drejt pjesës së jashtme.
2. Vendosni një tub muri të futur në vrimë.
3. Vendosni një veshje muri në tubin e murit.



a Tubacioni i futur në mur
b Stuko
c Kapaku i vrimës së murit

4. Pas përfundimit të instalimeve, vendosjes së tubacionit të ftohësit dhe kullimit, MOS harroni të izoloni boshllëkun me stuko.

6.3.3 Si të hiqni kapakun e portës së tubit

INFORMACION

Për të lidhur tubacionin në krahun e djathtë, në fund djathtas, në krahun e majtës ose në fund majtas, kapaku i portës së tubit DUHET të hiqet.

1. Prisni kapakun e portës së tubit nga brenda rrjetës së përparme duke përdorur një sharrë në formë U-je.



2. Hiqni çdo rrudhje përgjatë pjesës së prerjes duke përdorur një limë gjilpërë gjysmë të rrumbullakët.



NJOFTIM

MOS përdorni pinca për të hequr kapakun e portës së tubit, sepse kjo do të dëmtonte rrjetën e përparme.

6.4 Lidhja e tubacionit të kullimit

Në këtë kapitull

6.4.1 Udhëzimet e përgjithshme 31
6.4.2 Lidhja e tubacionit në krahun e djathtë, në pjesën e pasme ose fundore djathtas 32
6.4.3 Lidhja e tubacionit në krahun e majtë, në pjesën e pasme ose fundore majtas 32
6.4.4 Kontrolli për rrjedhje uji 33

6.4.1 Udhëzimet e përgjithshme

- **Gjatësia e tubit.** Mbajeni tubacionin e kullimit sa më të shkurtër të jetë e mundur.
- **Madhësia e tubit.** Nëse kërkohet zgjatimi i zorrës së kullimit ose tubacioni i futur i kullimit, përdorni pjesë të përshtatshme që përputhen me fundin e pjesës së përparme të zorrës.



NJOFTIM

- Instaloni zorrën e kullimit me një pjerrësi tatëpjetë.
- Laqet NUK lejohen.
- MOS e fusni pjesën fundore të zorrës në ujë.



- **Zgjatimi i zorrës së kullimit.** Për ta zgjatur zorrën e kullimit, përdorni një zorrë me diametër të brendshëm Ø16 mm. MOS harroni të përdorni tub për izolimin e nxehtësisë në pjesën e brendshme të zorrës së zgjatimit.



a Zorrë kullimi siguruar me njësinë e brendshme
b Tubi i izolimit të nxehtësisë (siguruar nga klienti)
c Zorrë zgjatimi për kullim

- **Tub i pathyeshëm klorid polivinili.** Kur lidhni një tub të pathyeshëm klorid polivinili (vlera nominale Ø13 mm) direkt me zorrën e kullimit si dhe me tubacionin e futur, përdorni një fole kullimi që sigurohet nga klienti (vlera nominale Ø13 mm).



a Zorrë kullimi siguruar me njësinë e brendshme
b Foleja e kullimit me vlerë nominale Ø13 mm (siguruar nga klienti)
c Tub i pathyeshëm klorid polivinili (siguruar nga klienti)

- **Kondensimi.** Merr masa kundër kondensimit. Izolo tubacionin e plotë të kullimit në ndërtesë.

1 Vendosni zorrën e kullimit në tubin e kullimit siç tregohet në figurën vijuese, që të MOS nxirret nga tubi i kullimit.



6.4.2 Lidhja e tubacionit në krahun e djathtë, në pjesën e pasme ose fundore djathtas

INFORMACION

Kur del nga fabrika tubacioni është nga krahu i djathtë. Për tubacionin e krahut të majtë, hiqni tubacionin nga ana e djathtë dhe instalojeni në anën e majtë.

1 Ngjitni zorrën e kullimit me ngjitës adeziv te fundi i tubave të ftohësit.

2 Mbështilleni bashkë zorrën e kullimit dhe tubat e ftohësit duke përdorur izolant.



A Tubacioni i krahut të djathtë
B Tubacioni fundor djathtas
C Tubacioni fundor prapa
a Hiqni kapakun e portës së tubit këtu për tubacionin e krahut të djathtë
b Hiqni kapakun e portës së tubit këtu për tubacionin fundor

6.4.3 Lidhja e tubacionit në krahun e majtë, në pjesën e pasme ose fundore majtas

INFORMACION

Kur del nga fabrika tubacioni është nga krahu i djathtë. Për tubacionin e krahut të majtë, hiqni tubacionin nga ana e djathtë dhe instalojeni në anën e majtë.

1 Hiqni vidhën e fiksimit të izolimit në krahun e djathtë dhe hiqni zorrën e kullimit.

2 Hiqni kandelen e kullimit në anën e majtë dhe ngjiteni me anën e djathtë.

NJOFTIM

MOS përdorni vaj lubrifikues (vaj ftohësi) në kandelen e kullimit kur e vendosni brenda. Kandelja e kullimit mund të përkeqësohet dhe shkaktojë rrjedhje kullimi nga kandelja.



a çelës heksagonal 4 mm

3 Vendosni zorrën e kullimit në krahun e majtë dhe mos harroni ta shtrëngoni me vidhën e fiksimit; përndryshe mund të ketë rrjedhje uji.



a Vidha e fiksimit të izolimit
b Zorra e kullimit

4 Ngjitni zorrën e kullimit dhe tubat e ftohësit nga ana fundore duke përdorur izolant.



A Tubacioni i krahut të majtë
B Tubacioni prapa majtas
C Tubacioni fundor majtas
a Hiqni kapakun e portës së tubit këtu për tubacionin e krahut të majtë
b Hiqni kapakun e portës së tubit këtu për tubacionin e krahut të majtë në fund

6.4.4 Kontrolli për rrjedhje uji

1 Hiqni filtrat e ajrit.

2 Hidhni ngadalë rreth 1 l ujë në tabakanë e kullimit dhe kontrolloni për rrjedhje uji.



7 Instalimi i tubacionit

Në këtë kapitull

7.1 Përgatitja e tubacionit të ftohësit 34
7.1.1 Kërkesat e tubacionit të ftohësit 34
7.1.2 Izolimi i tubacionit të ftohësit 35
7.2 Lidhja e tubacionit të ftohësit 35
7.2.1 Lidhja e tubacionit të ftohësit me njësinë e brendshme 35
7.2.2 Masat paraprake kur bëhet lidhja e tubacionit të ftohësit 35
7.2.3 Udhëzime kur kryen lidhjen e tubacionit të ftohësit 36
7.2.4 Udhëzimet për përthyerjen e tubit 37
7.2.5 Ngjeshje e fundit të tubit 37
7.2.6 Lidhja e tubacionit të ftohësit me njësinë e brendshme 38
7.2.7 Për të kontrolluar nyjat e tubacionit të ftohësit për rrjedhje pas ngarkimit të ftohësit 38

7.1 Përgatitja e tubacionit të ftohësit

7.1.1 Kërkesat e tubacionit të ftohësit

KUJDES

Tubacioni dhe nyjat e bashkimit të një sistemi të ndarë do të kryhen me nyja të përhershme kur të jenë brenda një hapësire të zënë përveç nyjave që lidhin tubacionin me njësitë e brendshme.

NJOFTIM

Tubacioni dhe pjesë të tjera presioni do të jenë të përshtatshme për ftohësin. Përdorni bakër fosforik dhe deoksidues pa shtresa për tubacionin e ftohësit.

INFORMACION

Lexoni gjithashtu masat paraprake dhe kërkesat në "2 Masat paraprake të sigurisë së përgjithshme" [▸ 7].

- Materialet e huaja brenda tubave (përfshirë vajrat për fabrikimin) duhet të jenë ≤30 mg/10 m.

Diametri i tubacionit të ftohësit

Përdorni të njëjtat diametra si lidhjet te njësia e jashtme:

Kategoria	Diametri periferik i tubit (mm)	
	Tubi i lëngjeve	Tubi i gazrave
20~35	Ø6,4	Ø9,5
42+50	Ø6,4	Ø12,7

Materiali i tubacionit të ftohësit

Materiali i tubacionit

Bakër i butë acido-fosforik i deoksiduar

Lidhjet e telit të zgjeruar

Përdor vetëm material të kalitur.

Shkalla e kalitjes dhe trashësia e tubacioneve

7.1.2 Izolimi i tubacionit të ftohësit

- Përdor sfungjer polietileni si material izolimi:
  - me një shkallë transferimi të nxehtësisë mes 0,041 dhe 0,052 W/mK (0,035 dhe 0,045 kcal/mh°C)
  - me një rezistencë ndaj ngrohjes prej të paktën 120°C
- Trashësia e izolimit:

Diametri periferik i tubit ($Ø_p$)	Diametri i brendshëm i izolimit ($Ø_i$)	Trashësia e izolimit (t)
6,4 mm (1/4")	8~10 mm	≥10 mm
9,5 mm (3/8")	12~15 mm	≥13 mm
12,7 mm (1/2")	14~16 mm	≥13 mm



Nëse temperatura është më e lartë se 30°C dhe lagështia është më e madhe se RH 80% (lagështia relative), trashësia e materialeve të izolimit duhet të jetë të paktën 20 mm për të parandaluar kondensimin mbi sipërfaqen e izolimit.

7.2 Lidhja e tubacionit të ftohësit

7.2.1 Lidhja e tubacionit të ftohësit me njësinë e brendshme

Para lidhjes së tubacionit të ftohësit

Sigurohu që njësia e jashtme dhe e brendshme janë montuar.

Ngarkesa tipike e punës

Lidhja e tubacionit të ftohësit përfshin:

- Lidhja e tubacionit të ftohësit me njësinë e brendshme
- Lidhja e tubacionit të ftohësit me njësinë e jashtme
- Izolimi i tubacionit të ftohësit
- Mbajtja parasysh e udhëzimeve për:
  - Lakimin e tubit
  - Zgjerimin e fundeve të tubit
  - Përdorimin e valvuleve të ndërprerjes

7.2.2 Masat paraprake kur bëhet lidhja e tubacionit të ftohësit

INFORMACION

Lexo gjithashtu masat paraprake dhe kërkesat në kapitujt vijues:

- "2 Masat paraprake të sigurisë së përgjithshme" [▸ 7]
- "7.1 Përgatitja e tubacionit të ftohësit" [▸ 34]

RREZIK: RREZIK DJEGIEJE//PËRVËLIMI

NJOFTIM

- Përdorni dadon e zgjerimit që është vendosur në njësi.
- Për të parandaluar rrjedhje të gazit, vendosni vaj ngrirjeje VETËM në brendësi të pjesës së zgjeruar. Përdorni vaj ngrirjeje për R32 (FW68DA).
- MOS i përdorni sërish kyçet.

NJOFTIM

- MOS përdorni vaj mineral në pjesën e zgjeruar.
- KURRË mos instaloni tharëse me këtë R32 për të garantuar jetëgjatësinë e saj. Materiali i tharjes mund të shpërbëhet dhe dëmtojë sistemin.

NJOFTIM

Merrni parasysh këto masa paraprake te tubacioni i ftohësit:

- Shmangni çdo gjë përveç përzierjes së ftohësit të caktuar në ciklin e tij (p.sh. ajri).
- Përdor vetëm R32 kur shton ftohës.
- Përdor vetëm veglat e instalimit (p.sh. kompleti i matësit të kolektorit), që përdoren ekskluzivisht për instalimet R32 për t'i rezistuar presionit dhe për të penguar materialet e huaja (p.sh. vajërat mineralë dhe lagështinë) nga përzierja në sistem.
- Instaloni tubacionin që zgjerimi MOS të bëhet subjekt i presionit mekanik.
- MOS i lini tubat pa mbikëqyrje në vendin e punës. Nëse instalimi NUK kryhet në 1 ditë, mbroni tubacionin siç përshkruhet në tabelën vijuese për të penguar hyrjen e pisllëkut, lëngjeve ose pluhurit në tubacion.
- Bëni kujdes kur kaloni tuba bakri nga muret (shikoni figurën e mëposhtme).



Njësia	Periudha e instalimit	Metoda e mbrojtjes
Njësia e jashtme	>1 muaj	Shtrëngo tubin
	<1 muaj	Shtrëngo tubin ose lidhe me ngjitëse
Njësia e brendshme	Pavarësisht periudhës	

7.2.3 Udhëzime kur kryen lidhjen e tubacionit të ftohësit

Merrni parasysh udhëzimet vijuese kur lidhni tubat:

- Vidhni sipërfaqen e brendshme të telit të zgjeruar me vaj eteri ose esteri kur lidhni dadon e telit të zgjeruar. Shtrëngojeni 3 ose 4 herë me dorë, para se ta shtrëngoni mirë.



- GJITHMONË përdor dy çelësa së bashku kur liron një dado ngjeshëse.
- Përdorni GJITHMONË një çelës dhe çift rrotullues së bashku për të shtrënguar dadon e telit të zgjeruar kur lidhni tubacionin. Kjo kryhet për të parandaluar plasaritjen dhe rrjedhjet e dados.



a Çift rrotullues
b Çelës
c Bashkues tubacioni
d Dado teli të zgjeruar

Madhësia e tubacionit (mm)	Çift rrotullues për shtrëngim (N•m)	Dimensionet e telit të zgjeruar (A) (mm)	Forma e telit zgjerues (mm)
Ø6,4	15~17	8,7~9,1	
Ø9,5	33~39	12,8~13,2	
Ø12,7	50~60	16,2~16,6	

7.2.4 Udhëzimet për përthyerjen e tubit

Përdor një përthyes për përthyerjen. Të gjitha përthyerjet e tubave duhet të jenë sa më të buta të jetë e mundur (rrezja e përthyerjes duhet të jetë 30~40 mm ose më e madhe).

7.2.5 Ngjeshje e fundit të tubit

KUJDES

- Ngjeshja e paplotë mund të shkaktojë rrjedhje të gazit të ftohësit.
- MOS ripërdorni ngjeshje. Përdor ngjeshje të reja për të parandaluar rrjedhjen e gazit të ftohësit.
- Përdorni dado ngjeshëse që përfshihen me njësinë. Përdorimi i dadove të ndryshme ngjeshëse mund të shkaktojë rrjedhjen e gazit të ftohësit.

1. Priteni fundin e tubit me një prerës.
2. Hiqni gërvimat me sipërfaqen prerëse përmbys në mënyrë që ciflat MOS të hyjnë në tub.



a Prisni me saktësi në këndet e duhura.
b Hiqni ciflat.

3. Hiqni dadon e zgjerimit nga valvuli i ndërprerjes dhe vendoseni atë në tub.
4. Zgjeroni tubin. Caktoni pikërisht pozicionin siç tregohet në figurën e mëposhtme.



	Vegël ngjeshëse për R32 (lloj shtrëngimi)	Vegël tradicionale ngjethëse	
		Lloj shtrëngimi (Lloji Ridgid)	Lloji i dados anësore (Lloji Imperial)
A	0~0,5 mm	1,0~1,5 mm	1,5~2,0 mm

5 Kontrolloni që zgjerimi të kryhet si duhet.



a Sipërfaqja e brendshme e zgjerimit DUHET të jetë e përsosur.
b Fundi i tubit DUHET të zgjerohet në mënyrë të barabartë në një rreth të përkryer.
c Sigurohuni që të përputhet dadoja e zgjerimit.

7.2.6 Lidhja e tubacionit të ftohësit me njësinë e brendshme

A2L

ALARM: MATERIAL QË NDIZET LEHTË

Ftohësi brenda kësaj njësie digjet lehtësisht.

- **Gjatësia e tubit.** Mbajeni tubacionin e ftohësit sa më të shkurtër të jetë e mundur.

1 Lidhni tubacionin e ftohësit me njësinë duke përdorur **lidhjet e telit të zgjeruar**.

2 Mbështillni lidhjen e tubit të ftohësit duke përdorur ngjitëse vinil, duke përkuar pjesërisht të paktën gjysmën e gjerësisë së ngjitëses me secilën radhë. Mbani të mbuluar çarjen e tubit të izolimit të nxehtësisë. Shmangni mbështjelljen e fortë të ngjitëses.



a Kapaku i tubit të izolimit të nxehtësisë (në anën e njësisë së brendshme)
b Lidhjet e telit të zgjeruar
c Tubi i lëngjeve (me izolim) (siguruar nga klienti)
d Tubi i gazrave (me izolim) (siguruar nga klienti)
e Çarja në kapakun e tubit të izolimit të nxehtësisë me fytyrë nga lart
f Ngjitëse vinili (siguruar nga klienti)

3 **Izoloni** tubacionin e ftohësit, kabllon e ndërlidhjes dhe zorrën e kullimit te njësia e brendshme: Shikoni "9.1 Izolimi i tubacionit të kullimit, të ftohësit dhe kabllos së ndërlidhjes" [▸ 46].

NJOFTIM

Sigurohu të izolosh të gjithë tubacionin e ftohësit. Çdo tubacion i ekspozuar mund të shkaktojë kondensim.

7.2.7 Për të kontrolluar nyjat e tubacionit të ftohësit për rrjedhje pas ngarkimit të ftohësit

1 Kryeni testimet për rrjedhje sipas udhëzimeve në instalim manualin për instalimin e njësisë së jashtme.

2 Ngarkoni ftohësin.

3 kontrolloni për rrjedhje të ftohësit pas ngarkimit (shikoni më poshtë).

Testim për nyjat e ftohësit përgatitur në terren për njësitë e brendshme

1 Përdorni një metodë të testimit të rrjedhjes me një ndjeshmëri minimale prej 5 g të ftohësit në vit. Testoni rrjedhjet duke përdorur një presion prej të paktën 0,25 herë maksimumin e presionit funksional (shiko "PS High" në pllakën metalike të njësisë).

Nëse zbulohet një rrjedhje

1 Rikuperoni ftohësin, riparoni nyjën dhe përsëritni testimin.

8 Instalimi elektrik

Në këtë kapitull

8.1 Rreth lidhjes së instalimeve elektrike 40
8.1.1 Masat paraprake kur kryen lidhjet e instalimeve elektrike 40
8.1.2 Udhëzimet kur kryen lidhjet e instalimeve elektrike 41
8.1.3 Specifikimet e përbërësve standardë të instalimeve elektrike 43
8.2 Lidhja e instalimeve elektrike me njësinë e brendshme 43
8.3 Lidhja e aksesorëve opsionalë (ndërfaqja e përdoruesit të lidhur, ndërfaqja e përdoruesit qendror, etj.) 45

8.1 Rreth lidhjes së instalimeve elektrike

Para se të bëni lidhjen e instalimeve elektrike

Sigurohuni që tubacioni i ftohësit është i lidhur dhe kontrolluar.

Ngarkesa tipike e punës

Lidhja e instalimeve elektrike zakonisht përbëhet nga këto faza:

1 Sigurohuni që sistemi i furnizimit me energji elektrike përputhet me specifikimet elektrike të njësive.
2 Lidhja e instalimeve elektrike me njësinë e jashtme.
3 Lidhja e instalimeve elektrike me njësinë e brendshme.
4 Lidhja e furnizimit me energjinë kryesore elektrike.

8.1.1 Masat paraprake kur kryen lidhjet e instalimeve elektrike

RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE

PARALAJMËRIM

- Të gjitha instalimet elektrike DUHEN kryer nga një elektricist i autorizuar dhe DUHET të pajtohen me rregulloren kombëtare të instalimeve elektrike.
- Kryeni lidhjet elektrike tek instalimet e montuara.
- Të gjithë komponentët e prokuruar në vend dhe të gjitha punimet elektrike DUHET të përputhen me legjislacionin në fuqi.

PARALAJMËRIM

GJITHMONË përdor kabllo me shumë bërthama për kabllot e furnizimit me energji elektrike.

INFORMACION

Lexoni gjithashtu masat paraprake dhe kërkesat në "2 Masat paraprake të sigurisë së përgjithshme" [▸ 7].

INFORMACION

Gjithashtu lexoni "8.1.3 Specifikimet e përbërësve standardë të instalimeve elektrike" [▸ 43].

PARALAJMËRIM

- Nëse furnizimit me energji elektrike i mungon faza-N ose është e gabuar, pajisja mund të prishet.
- Vendos tokëzimin e duhur. MOS e tokëzoni njësinë te tubat e shërbimeve utilitare, përthithësi i fryrjeve apo tokëzimet e telefonit. Tokëzimi i paplotë mund të shkaktojë goditje elektrike.
- Instalo siguresat e kërkuara ose siguresat e qarkut.
- Siguroji instalimet elektrike me lidhëse kabllosh që kabllot të mos bin në kontakt me tehet e mprehta apo tubacionin, veçanërisht në anën e presionit të lartë.
- MOS e instaloni kondensatorin për përparimin e fazës, sepse kjo pajisje është e pajisur me një inverter. Kondensatori për përparimin e fazës ul performancën dhe mund të shkaktojë aksidente.

PARALAJMËRIM

Përdorni një lloj çelësi për ndërprerje me të gjitha polet me të paktën 3 mm mes hapësirave të pikës së kontaktit që ofron ndërprerje të plotë sipas kategorisë III të mbitensionit.

PARALAJMËRIM

Nëse kordoni i korrentit është i dëmtuar, DUHET të ndërrohet nga prodhuesi, agjenti i shërbimit ose persona të ngjashëm të kualifikuar për të shmangur një rrezik.

PARALAJMËRIM

MOS e zgjatni kabllon e korrentit ose të ndërlidhjes duke përdorur lidhës telash, kapëse telash, tela me ngjitëse, zgjatues.

Këta mund të shkaktojnë mbinxehje, goditje elektrike ose zjarr.

PARALAJMËRIM

MOS e lidhni furnizimin e energjisë me njësinë e brendshme. Kjo mund të rezultojë në shok elektrik ose zjarr.

PARALAJMËRIM

- MOS përdorni pjesë elektrike të blera lokalisht brenda produktit.
- MOS e degëzoni furnizimin me energji elektrike për pompën e kullimit, etj. nga blloku terminal. Kjo mund të rezultojë në shok elektrik ose zjarr.

PARALAJMËRIM

Sistemin e instalimit të ndërlidhjes mbajeni larg tubave të bakrit pa izolim termal, sepse mund të jenë shumë të nxehta.

8.1.2 Udhëzimet kur kryen lidhjet e instalimeve elektrike

NJOFTIM

Rekomandojmë përdorimin e telave të fortë (tek bërthamë). Nëse përdoren telat e bllokuar, rrotulloni ngadalë telat për të konsoliduar fundin e përçuesin për secilin prej përdorim të drejtpërdrejtë në kapësen e terminalit ose vendosjen në një terminal të rrumbullakët të llojit dredhë.

Përgatitja e telit të bllokuar të përçuesit për instalim

Metoda 1: Përdredhja e përçuesit

1 Hiqni izolimin (20 mm) nga telat.

2 Përdridhni ngadalë anën fundore të përçues për të krijuar një lidhje "të fortë".



Metoda 2: Përdorimi i terminalit të rrumbullakët të llojit dredhë (rekomandohet)

1 Zhvishni izolimin nga telat dhe përdridhni ngadalë fundin e secilit tel.

2 Vendosni një terminal të rrumbullakët të llojit dredhë në fundin e telit. Vendosni terminalin e rrumbullakët i llojit dredhë në tel deri te pjesa e mbuluar dhe shtrëngoni terminalin me mjetin e duhur.



Përdorni metodat vijuese për instalimin e telave:

Lloji i telit	Metoda e instalimit
Tel me tek bërthamë Ose Teli i bllokuar i përçuesit i përdredhur në lidhje "të fortë"	 **a** Tel i dredhur (teli i bllokuar i përçuesit me tek bërthamë ose i përdredhur) **b** Vidhë **c** Rondele e sheshtë
Tel i bllokuar përçuesi me terminal të rrumbullakët të llojit dredhë	 **a** Terminal **b** Vidhë **c** Rondele e sheshtë ✓ Lejohet ✕ NUK lejohet

- Teli i tokëzuar mes mbajtësit të instalimeve dhe terminalit duhet të jetë më i gjatë se telat e tjerë.



8.1.3 Specifikimet e përbërësve standardë të instalimeve elektrike

Përbërësi		
Kablloja e ndërlidhjes (brenda↔jashtë)	Voltazhi	220~240 V
	Madhësia e telit	Përdorni vetëm tel të harmonizuar që ofrojnë izolim të dyfishtë dhe janë të përshtatshëm për voltazhin në përdorim Kabllo me 4 bërthama Minimumi 1,5 mm²
Pajisja reziduale e tokëzimit / siguresa e rrjedhjes së tokëzimit	Në linjën e furnizimit duhet të instalohet një çelës rryme të mbetur, i cili përputhet me rregulloret e lidhjeve elektrike kombëtare. GJITHMONË instaloni një çelës rryme të mbetur me një veprim të menjëhershëm, përveç nëse përcaktohet ndryshe nga rregullorja kombëtare e instalimeve elektrike.	

8.2 Lidhja e instalimeve elektrike me njësinë e brendshme

PARALAJMËRIM

MOS e zgjatni kabllon e korrentit ose të ndërlidhjes duke përdorur lidhës telash, kapëse telash, tela me ngjitëse, zgjatues.

Këta mund të shkaktojnë mbinxehje, goditje elektrike ose zjarr.

PARALAJMËRIM

Merr masa të përshtatshme për të parandaluar që njësia të përdoret si strehë nga kafshë të vogla. Kafshët e vogla që bien në kontakt me pjesët elektrike mund të shkaktojnë ndërprerjen e funksionit, tym ose zjarr.

NJOFTIM

- Mbani instalimet elektrike të energjisë dhe të ndërlidhjes të ndara nga njëra-tjetra. Instalimet elektrike të ndërlidhjes dhe furnizimi me energji elektrike mund të kryqëzohen, por NUK mund të punojnë paralel.
- Për të shmangur çdo lloj interferimi elektrik distanca mes të dy instalimeve duhet të jetë GJITHMONË të paktën 50 mm.

Punët elektrike duhen kryer në përputhje me manualin e i instalimit dhe rregullat kombëtare të instalimeve elektrike apo kodin e praktikës.

1 Vendoseni njësinë e brendshme në çengelët e pllakës së montimit. Përdorni shenjat "△" si udhëzues.



a Pllaka e montimit (aksesor)
b Pjesë e materialit paketues
c Kablloja e ndërlidhjes

d Udhëzuesi i telit

INFORMACION

Mbështetni njësinë duke përdorur një pjesë të materialit paketues.

Shembull:



2 Hapnin panelin para dhe pastaj kapakun e shërbimit. Referojuni "6.2 Hapja e njësisë" [▸ 25].

3 Kaloni kabllon e ndërlidhjes nga njësia e jashtme përmes mekanizmit të furnizimit dhe vrima e murit, nëpërmjet pjesës prapa të njësisë së brendshme dhe nga ana para.

Shënim: Në rast se kablloja e ndërlidhjes është zhveshur përpara, mbuloni pjesën fundore me izolant.

4 Përkulni fundin e kabllos për lart.



a Blloku i terminalit
b Blloku i përbërësit elektrik
c Kapësja e kabllos

5 Zhvishni rreth 15 mm pjesët fundore të telit.

6 Përshtatni ngjyrat e telit me numrat e terminalit në blloqet e terminalit të njësisë së e brendshme dhe vidhosni mirë telat me terminalet përkatëse.

7 Lidhni telin e tokëzimit me terminalin përkatës.

8 Fiksoni mirë telat me vidat e terminalit.

9 Tërhiqni telat për t'u siguruar që janë të ngjitur në mënyrë të sigurt, pastaj ruani telat me mbajtësen e telave.

10 Jepuni telave formë në mënyrë që kapaku i shërbimit të përputhet mirë, pastaj mbylleni atë.



8.3 Lidhja e aksesorëve opsionalë (ndërfaqja e përdoruesit të lidhur, ndërfaqja e përdoruesit qendror, etj.)

1 Heqja e kapakut të kutisë së instalimeve elektrike (referojuni "6.2.5 Heqja e kapakut të kutisë së instalimeve elektrike" [▸ 28]).

2 Ngjitni kabllon e lidhjes me lidhësin S21 dhe tërhiqni rripin e telit siç tregohet në figurën e mëposhtme.



a Lidhësi S21

3 Vendosni sërish kapakun e kutisë së instalimeve elektrike dhe tërhiqni rripin e telit përreth tij siç tregohet në figurën e mësipërme.

9 Përfundimi i instalimit të njësisë së brendshme

9.1 Izolimi i tubacionit të kullimit, të ftohësit dhe kabllos së ndërlidhjes



a Çarja
b Kapaku i tubit të izolimit të nxehtësisë
c Tubi i lëngjeve
d Tubi i gazrave
e Tubi i kullimit
f Kablloja e ndërlidhjes
g Izolant
h Ngjitës vinili

1 Pas përfundimit të tubacionit të kullimit, të ftohësit dhe lidhjes elektrike, mbështillni bashkë tubat e ftohësit, kabllon e ndërlidhjes dhe zorrën e kullimit duke përdorur izolantin. Përkoni të paktën gjysmën e gjerësisë së ngjitëses nga secila radhë.



a Zorra e kullimit
b Kablloja e ndërlidhjes
c Pllaka e montimit (aksesor)
d Tubacioni i ftohësit
e Vidha e montimit të njësisë së brendshme M4×12L (aksesor)
f Korniza fundore

9.2 Kalimi i tubave ftohësit përmes vrimës së murit



a Zorra e kullimit
b Stukoni vrimën me stuko ose material stukues
c Ngjitës adeziv
d Izolant
e Pllaka e montimit (aksesor)

NJOFTIM

- MOS i përkulni tubat e ftohësit.
- MOS i shtyni tubat e ftohësit brenda kornizës fundore ose rrjetës së përparme.



1 Kalojeni zorrën e kullimit dhe tubat e ftohësit përmes vrimës së murit dhe boshllëkun izolojeni me stuko.

9.3 Fiksimi i njësisë mbi pllakën e montimit

1 Vendoseni njësinë e brendshme mbi mbajtëset e pllakës së montimit. Përdorni shënimet "△" si udhëzues.



2 Shtypni kornizën fundore të njësisë me të dy duart për ta vendosur mbi grremçat fundorë të montimit. Sigurohuni që telat NUK ngjeshën kund.

Shënim: Siguroni që kablloja e ndërlidhjes NUK kapet te njësia e brendshme.

3 Shtypni buzën fundore të njësisë së brendshme të dy duart derisa të kapet mirë nga grremçat e pllakës së montimit.

4 Siguroni njësinë e brendshme me pllakën e montimit duke përdorur 2 vidha të montimit të njësisë së brendshme M4×12L (aksesor).

9.4 Mbyllja e njësisë

9.4.1 Ri-instalimi i rrjetës së përparme

1 Instaloni rrjetën e përparme dhe shtrëngoni fort 3 grremçat e sipërm.

2 Shtrëngoni 2 vidhat dhe vendosni sërish 2 kapakët e vidhave.

3 Rivendosni krahun anësor.

4 Vendoseni sërish rripin e telit te lidhësi dhe fiksojeni me kapësen e telit.

5 Mbyllni panelin e përparmë. Referojuni "9.4.4 Mbyllja e panelit të përparmë" [▸ 48].

9.4.2 Mbyllja e kapakut të shërbimit

1 Vendosni kapakun e shërbimit në vendin e tij fillestar në njësi.

2 1 vidhë instalojeni sërish në kapakun e shërbimit.

NJOFTIM

Kur mbyllni kapakun e shërbimit, sigurohuni që çifti rrotullues i shtrëngimit NUK e kalon 1.4 (±0.2) N•m.

9.4.3 Ri-instalimi i panelit të përparmë

1. Ngjitni panelin e përparmë.
2. Drejtoni boshtin në anën e djathtë me slotin e boshtit dhe shtyjini përbrenda deri në fund.
3. Shtyni ngadalë panelin e përparmë në anën e djathtë, drejtoni boshtin në anën e majtë me slotin dhe shtyjini përbrenda deri në fund.
4. Mbyllni kyçet në të dy krahët.

9.4.4 Mbyllja e panelit të përparmë

1. Ngrini ngadalë panelin e përparmë dhe hiqeni mbështetësen nga skeda e montimit.



a Ana e pasme e panelit të përparmë
b Skeda e montimit
c Mbështetje

2. Mbyllni panelin e përparmë.



3. Shtypeni ngadalë panelin e përparmë për poshtë derisa të zër vend.

9.4.5 Instalimi i kapakëve të vidhave

1. Hapni panelin e përparmë dhe pastaj kapakun e xhepit.
2. Vendosni të dy kapakët e vidhave (1 në secilin krah).



3. Kthejeni kapakun e xhepit në pozicionin fillestar dhe mbyllni panelin e përparmë.

10 Vënia në punë

NJOFTIM

Lista e plotë e komisionimit të përgjithshëm. Përkrah udhëzimeve të komisionimit në këtë kapitull, disponohet gjithashtu një listë e plotë e komisionimit të përgjithshëm në Daikin Library (kërkohet vërtetimi).

Lista e plotë e komisionimit të përgjithshëm është plotësuese e udhëzimeve në këtë kapitull dhe mund të përdoret si udhëzim dhe shabllon raportimi gjatë komisionimit dhe dorëzimit te përdoruesi.

10.1 Pamja e përgjithshme: Autorizimi

Ky kapitull përshkruan se çfarë duhet të bësh dhe dish për të autorizuar sistemin pasi të jetë instaluar.

Ngarkesa tipike e punës

Zakonisht komisionimi kalon në këto faza:

1 Kontrollimi i "Kontrollo listën e artikujve para autorizimit".

2 Kryerja e një testimi për sistemin.

10.2 Lista e plotë para komisionimit

1 Pas instalimit të njësisë, kontrolloni artikujt e renditur më poshtë.

2 Mbyllni njësinë.

3 Ndizni njësinë.

☐	Lexo udhëzimet e instalimit të plotë, siç përshkruhen në **udhëzuesin e instaluesit të referimit**.
☐	**Njësitë e brendshme** janë montuar siç duhet.
☐	**Njësia e jashtme** është montuar siç duhet.
☐	**Hyrja/dalja e ajrit** Kontrolloni që hyrja dhe dalja e ajrit nga njësia NUK pengohet nga letra, kartoni apo ndonjë material tjetër.
☐	NUK ka **faza që mungojnë** apo **që kthehen mbrapsht**.
☐	**Tubat e ftohësit** (të gazit dhe lëngut) janë të izoluara termikisht.
☐	**Kullimi** Sigurohuni që kullimi qarkullon pa probleme. **Pasoja e mundshme:** Uji i kondensuar mund të pikojë.
☐	Sistemi është **tokëzuar** siç duhet dhe terminalet e tokëzimit janë shtrënguar.
☐	**Siguresat, çelësat** ose **pajisjet e mbrojtjes të instaluara lokalisht** të një madhësie dhe lloji të specifikuar në këtë dokument dhe NUK kanë kaluar në rrugë anësore.
☐	**Voltazhi i furnizimit me energji elektrike** përputhet me voltazhin në etiketën identifikuese të njësisë.
☐	Telat e specifikuar përdoren për **kabllon e ndërlidhjes.**
☐	Njësia e brendshme merr sinjale të ndërfaqes së përdoruesit.

☐	NUK ka **lidhje të lira** ose përbërës të dëmtuar elektrikë në kutinë e çelësit.
☐	**Rezistenca e izolimit** të kompresorit është NË RREGULL.
☐	NUK ka **përbërës të dëmtuar** ose **tuba të ngjeshur** në pjesën e brendshme të njësive të brendshme dhe jashtme.
☐	NUK ka **rrjedhje të ftohësit**.
☐	Madhësia e duhur e tubit instalohet dhe **tubat** izolohen siç duhet.
☐	**Valvulet e ndalimit** (gazit dhe lëngjeve) në njësinë e jashtme janë plotësisht të hapura.

10.3 Kryerja e një testimi

Kushti paraprak: Energjia elektrike DUHET të jetë brenda rrezes së specifikuar.

Kushti paraprak: Ekzekutimi i testimit mund të kryhet në gjendje ftohjeje ose ngrohjeje.

Kushti paraprak: Referojuni manualit të përdorimit të njësisë së brendshme për të caktuar temperaturën, modalitetin e operimit….

1. Në gjendjen ftohje, zgjidhni temperaturën më të ulët të programuar. Në gjendje ngrohje, zgjidhni temperaturën më të lartë të programuar. Ekzekutimi i testimit mund të çaktivizohet nëse është e nevojshme.
2. Kur të mbarojë ekzekutimi i testimit, caktoni temperaturën në një nivel normal. Në gjendje ftohje: 26~28°C, në gjendje ngrohje: 20~24°C.
3. Sigurohuni që të gjitha funksionet dhe pjesët funksionojnë si duhet.
4. Sistemi ndalon së operuari 3 minuta pas FIKJES së njësisë.

10.3.1 Kryerja e një testimi duke përdorur telekomandën

1. Shtypni ··· për të hyrë në menynë kryesore dhe navigoni për te "Menyja e cilësimeve të telekomandës uajrles" me ‹ dhe ›. Shtypni ✓ për hyrë në meny.
2. Navigoni për tek ekrani "Softueri dhe versioni" me ‹ dhe ›.
3. Mbajeni ✓ shtypur për të paktën 5 sekonda për të hyrë në "Menynë e vetë-diagnostikimit".

Menyja e cilësimit të kontrollit të telekomandës



Menyja e vetë-diagnostikimit



4. Në "Menynë e vetë-diagnostikimit", navigoni për te "Menyja e testimit" me ‹ dhe ›.

Menyja e testimit



5. Shtypni ✓ për të hyrë në meny.

6 Ndryshoni statusin në ON me ^ dhe v.

7 Shtypni v për të konfirmuar zgjedhjen.

Rezultati: Njësia e brendshme hyn në modalitetin e operimit të testimit, gjatë të cilit operimi normal nuk është i mundur.

Menyja e testimit FIKUR



Menyja e testimit NDEZUR



Gjatë testimit



Rezultati: Operimi i ekzekutimit të testimit ndalon automatikisht pas 30 minutave.

8 Modaliteti i testimit do të ndalojë nëse shtypet butoni i NDEZJES/FIKJES.

Rezultati: Njësitë e brendshme dalin nga modaliteti i operimit.

9 Kontrolloni funksionin e modaliteteve të operimit.

INFORMACION

NUK MUND të caktoni Econo, njësinë e brendshme në heshtje dhe operimin e fuqishëm ose ndryshoni vlerën e dëshiruar të temperaturës gjatë testimit.

10 Kontrolloni historinë e kodit të gabimit. Nëse kërkohet, zgjidhni shkakun e gabimeve dhe kryeni sërish operimin e testimit.

INFORMACION

- Testimi përfundon vetëm nëse njësia e brendshme nuk raporton ndonjë kod gabimi.
- Shikoni manualin e shërbimit për listën e plotë të kodeve të gabimit dhe për një udhëzues të detajuar të zgjidhjes së problemeve për secilin gabim.

11 Konfigurimi

INFORMACION

Për "Konfigurimin" duke përdorur telekomandën uajrles, referojuni **udhëzuesit referencë të instaluesit** që gjendet në https://qr.daikin.eu/?N=FTXJ-BW nën "Dokumentacioni".

- **Cilësimi i njësisë së brendshme:** ndriçimi i Daikin Eye, hapni panelin e përparmë, lidhja uajrles LAN, funksioni i qarkullimit vertikal të ajrit, pozicioni i instalimit të njësisë së brendshme, mbani funksionin e tharjes
- **Cilësimi i telekomandës uajrles:** Kontrasti LCD, ndriçimi LCD, koha e fikjes së LCD, dërgim automatik pas zgjedhjes, kanalet e marrësit infra të kuq të njësisë së brendshme

11.1 Kontakti i ndezjes/fikjes

Ky funksion kërkon blerjen dhe instalimin e opsionit KER303A.

Për një përshkrim të funksionit, qëllimit dhe mënyrës se si funksionon, referojuni manualit të operimit, kapitullit "Kontakti i ndezjes/fikjes".

INFORMACION

Lloji i kontaktit dhe koha e vonesës caktohen te menuja e shërbimit.

- Lloji i kontaktit: zakonisht i hapur (NO), zakonisht i mbyllur (NC) - cilësimi i fabrikës
- Koha e vonesës: 0 - cilësimi i fabrikës, 1, 2, 3, 5 minuta

Shembull: zakonisht i mbyllur (NC)

Kur mbyllet kontakti (dritarja është e mbyllur, karta është e futur), njësia operon si zakonisht.

Kur hapet kontakti (dritarja është e hapur, karta është e hequr), fillon kohëmatësi i vonesës. Njësia ndalon pas kohës së caktuar të vonesës.

Ju rekomandojmë të caktoni një kohë vonese për të parandaluar dridhjen e sinjalit nga zhurma.

INFORMACION

Pas kohës së zgjedhur të vonesës (0, 1, 2, 3, 5 minuta), njësia ndalon dhe kalon në gjendjen e gatishmërisë.

Ndërsa statusi i kontaktit tregon dritare të hapur:

- Komanda e NDEZJES/FIKJES nga telekomanda ose aplikacioni ONECTA është e çaktivizuar.
- Cilësimet e tjera, si vlera e dëshiruar, modaliteti ose shpejtësia e ventilatorit, mund të ndryshohen, por do të hyjnë në fuqi vetëm pas rifillimit të njësisë.

Shënim: Daikin rekomandon përdorimin e llojit të kontaktit **zakonisht i mbyllur (NC)**. Kjo e parandalon njësinë që të operojë kur kontakti nuk funksionon.

Cilësimi i Aktivizimit / Rifillimit

Modaliteti i rifillimit përcakton se si njësia operon pasi dritarja mbyllet sërish.

Rifillimi manual

Njësia nuk rifillon automatikisht.

Operimi duhet të rifillojë manualisht duke përdorur **telekomandën** ose aplikacionin ONECTA.

Rifillimi automatik

Njësia rifillon automatikisht në modalitetin e fundit të operimit pas mbylljes së dritares.

11.1.1 Caktimi i kontaktit në ndezje/fikje

1. Hyni në menynë kryesore duke shtypur ··· dhe navigoni për te menyja e cilësimit të telekomandës uajrles duke përdorur < dhe >.
2. Shtypni ✓ për të hyrë në meny.

Menyja e cilësimit të kontrollit të telekomandës uajrles



3. Navigoni për tek ekrani SW duke përdorur < dhe >.
4. Mbajeni ✓ të shtypur për të paktën 5 sekonda.

Ekzekutimi i testimit



5. Mbajeni ✓ të shtypur për të paktën 5 sekonda.

Cilësimi i fjalëkalimit



6. Përdorni ^, ✓, >, dhe < për të futur fjalëkalimin 5902 dhe shtypni ✓.

Modaliteti i inspektimit



7. Navigoni për te cilësimi i kontaktit të Jashtëm duke përdorur < dhe >.
8. Shtypni ✓ për të hyrë në cilësimin e Kontaktit.

Cilësimi i kontaktit



9 Mbajeni ✓ të shtypur për të paktën 3 sekonda.

10 Përdorni ^ dhe v për të zgjedhur OFF, MANU, AUTO.

11 Shtypni ✓.

Rezultati: Ekrani kthehet te cilësimi i Kontaktit.

12 Përdorni < dhe > për të naviguar për te lloji i Kontaktit.

Lloji i kontaktit



13 Mbajeni ✓ të shtypur për të paktën 3 sekonda.

14 Përdorni ^ dhe v për të zgjedhur NO ose NC.

15 Shtypni ✓.

Rezultati: Ekrani kthehet te lloj i Kontaktit.

16 Përdorni < dhe > për të naviguar te cilësimi i kohës së Vonesës

Cilësimi i kohës së vonesës



17 Mbajeni ✓ të shtypur për të paktën 3 sekonda.

18 Përdorni ^ dhe v për të zgjedhur kohën e vonesës: 0/1/2/3/5 min.

19 Shtypni ✓.

20 Shtypni ··· për t'u kthyer tek ekrani kryesor ose shtypni ✓ për t'u kthyer te menyja e Shërbimit

12 Kthimi te përdoruesi

Sapo të mbarojë testimi dhe njësia të punojë si duhet, sigurohuni që për përdoruesin këto të jenë të qarta:

- Kontrolloni që përdoruesi e ka dokumentacionin të printuar dhe kërkojini që ta mbajë për referencë në të ardhmen. Informoni përdoruesin që ai/ajo mund të gjejë dokumentacionin e plotë në URL-në e përmendur më herët në këtë manual.
- Sqaroni për përdoruesin si ta përdorë si duhet sistemin dhe çfarë të bëjë në rast problemesh.
- Tregojani përdoruesit çfarë të bëjë për mirëmbajtjen e njësisë.

13 Zgjidhja e problemeve

13.1 Zgjidhja e problemeve bazuar te kodet e gabimit

Diagnoza e defekteve me telekomandën uajrles

Nëse njësia has në një problem, mund të identifikoni defektin duke kontrolluar kodin e gabimit nga telekomanda uajrles. Është e rëndësishme të kuptohet problemi dhe marrja e masave para rivendosjes së kodit të gabimit. Kjo duhet të bëhet nga një instalues i licencuar ose distributori juaj lokal.

Për të kontrolluar kodin e gabimit nga telekomanda uajrles

1 Shtypni ··· për të hyrë në menynë kryesore dhe navigoni për te menyja e cilësimeve të telekomandës uajrles duke përdorur < dhe >.

Menyja e cilësimit të kontrollit të telekomandës



Versioni i softuerit (menyja e vetë-diagnostikimit)



2 Shtypni ✓ për të hyrë në meny.

3 Navigoni për te softueri dhe ekrani i versionit duke përdorur < dhe >.

4 Mbani ✓ shtypur për të paktën 5 sekonda për të hyrë në menynë e vetë-diagnostikimit.

5 Navigoni për tek ekrani i tregimit të kodit të gabimit duke përdorur < dhe >. Shtypni ✓ për të konfirmuar zgjedhjen.

Tregues i kodit të gabimit



Lista e kodit të gabimit



6 Synoni kontrollin e telekomandës në njësi dhe shikoni listën e kodeve të gabimit duke përdorur < dhe >, derisa të dëgjoni një bip të gjatë.

Rezultati: Një bip i gjatë tregon kodin përkatës të gabimit.

7 Shtypni ··· për t'u kthyer në ekranin kryesor ose shtypni ✓ për t'u kthyer te menyja e vetë-diagnostikimit.

INFORMACION

Shikoni manualin e shërbimit për:

- Listën e plotë të kodeve të gabimit
- Një udhëzim më të detajuar për zgjidhjen e problemeve për secilin gabim

Pozicioni	Kodi i gabimit	Përshkrimi
1	00	Normal
2	A5	Njësia e jashtme: Problem me mbrojtjen nga prerja/ngrirja e presionit të lartë në kulmin e tij

Pozicioni	Kodi i gabimit	Përshkrimi
3	E7	Njësia e jashtme: Keqfunksionim i motorit të ventilatorit të njësisë së jashtme
4	F3	Njësia e jashtme: Keqfunksionim i temperaturës së tubit të shkarkimit
5	F6	Njësia e jashtme: Presion i lartë anormal në ftohje
6	L3	Njësia e jashtme: Problem me rritjen e temperaturës së kutisë elektrike
7	L4	Njësia e jashtme: Keqfunksionim i rritjes së temperaturës të krahut të rrezatimit të inverterit
8	L5	Njësia e jashtme: Mbirryma e menjëhershme e inverterit
9	U4	Problemi me komunikimin e njësisë së brendshme/jashtme
10	E6	Njësia e jashtme: Defekt i nisjes së kompresorit
11	H6	Njësia e jashtme: Keqfunksionim i sensorit të zbulimit të pozicionit
12	H0	Njësia e jashtme: Problem me sensorin e voltazhit/rrymës
13	A6	Anomali me motorin e ventilatorit të njësisë së brendshme
14	U0	Njësia e jashtme: Sasi e pakët e ftohësit
15	C7	Njësia e brendshme: Gabimi për hapjen ose mbylljen e panelit të përparmë
16	A3	Njësia e brendshme: Anomali i sistemit të kontrollit të nivelit të kullimit
17	H8	Njësia e jashtme: Keqfunksionimi i sistemit të hyrjes së kompresorit
18	H9	Njësia e jashtme: Keqfunksionimi i termistorit të ajrit të jashtëm
19	C9	Anomali i termistorit të dhomës
20	CC	Anomali e sensorit të lagështisë
21	C4	Problem me sensorin e temperaturës së shkëmbyesit të nxehtësisë
22	C5	Problem me termistorin e tubit të gazrave për shkëmbyesin e nxehtësisë
23	J3	Njësia e jashtme: Keqfunksionim i termistorit të tubit të shkarkimit
24	J6	Njësia e jashtme: Keqfunksionim i termistorit të shkëmbyesit të ngrohjes
25	J8	Problem me termistorin e qarkut të ftohësit
26	E5	Njësia e jashtme: Mbinxehje e motorit të kompresorit të inverterit
27	A1	Anomali e PCB
28	E1	Njësia e jashtme: Defekt i PCB

Pozicioni	Kodi i gabimit	Përshkrimi
29	UA	Problem mospërputhjeje me njësisë e brendshme, njësinë e jashtme
30	U3	Kontrolloni operimin e pa ekzekutuar ose gabim në transmision
31	UL	Keqfunksionim i sistemit
32	P4	Njësia e jashtme: Keqfunksionim i sensorit të temperaturës së fletës së rrezatimit
33	H7	Njësia e jashtme: Keqfunksionim i sinjalit të motorit të ventilatorit të njësisë së jashtme
34	U2	Njësia e jashtme: Defekt i voltazhit të furnizimit me energji
35	EA	Njësia e jashtme: Problem me ndërrimin e ftohjes/ngrohjes
36	AH	Njësia e brendshme: Anomali i njësisë së Streamer
37	FA	Njësia e jashtme: Aktivizim i presionit të lartë anormal të çelësit të presionit të lartë
38	E3	Njësia e jashtme: Aktivizimi i çelësit të presionit të lartë
39	H3	Njësia e jashtme: Keqfunksionimi i çelësit të presionit të lartë
40	F8	Fikja e sistemit për shkak të anomalisë me temperaturën e brendshme të kompresorit
41	E8	Njësia e jashtme: Mbivoltazh i energjisë hyrëse
42	P9	Njësia e jashtme: Operimi automatik i ngarkimit të ftohësit përfundoi

14 Hedhja

NJOFTIM

MOS provoni ta çmontoni vetë sistemin: çmontimi i sistemit, menaxhimi i ftohësit, vajit dhe pjesëve të tjera DUHET të përputhet me legjislacionin në fuqi. Njësitë DUHET të trajtohen në një vend për trajtim të specializuar për ripërdorim, riciklim dhe rikuperim.

15 Të dhënat teknike

- Një **nëngrup** i të dhënave më të fundit teknike disponohen në faqen rajonale të internetit Daikin (e aksesueshme nga publiku).
- **Grupi i plotë** i të dhënave më të fundit teknike disponohen në Daikin Library (kërkohet vërtetimi).

15.1 Skema e instalimeve elektrike

Skema e instalimeve elektrike jepet bashkë me njësinë, e cila gjendet në anën e brendshme djathtas të grilës së përparme të njësisë së brendshme.

15.1.1 Legjenda e unifikuar e skemës së instalimeve elektrike

Për pjesët dhe numërimin e zbatuar, referojuni skemës së rrjetit të telave në njësi. Numërimi i pjesëve bëhet me numra arabikë sipas rendit ngjitës për secilën pjesë dhe përfaqësohet te pasqyra poshtë nga "*" te kodi i pjesës.

Simboli	Kuptimi	Simboli	Kuptimi
	Çelësi		Tokëzimi mbrojtës
			Tokëzimi i qetë
			Tokëzimi mbrojtës (vidhë)
	Lidhja	Ⓐ,	Detektori
	Lidhësi		Lidhësi i relesë
	Tokëzimi		Lidhësi me qark të shkurtër
	Instalimet në terren		Terminali
	Siguresa		Rripi i terminalit
INDOOR	Njësia e brendshme	○ ●	Kapësja e telit
OUTDOOR	Njësia e jashtme		Ngrohësi
	Pajisja reziduale korrenti		

Simboli	Ngjyra	Simboli	Ngjyra
BLK	E zezë	ORG	Portokalli
BLU	Blu	PNK	Rozë
BRN	Kafe	PRP, PPL	E purpurt
GRN	Jeshil	RED	E kuqe
GRY	Gri	WHT	E bardhë
SKY BLU	Blu qielli	YLW	E verdhë

Simboli	Kuptimi
A*P	Qarku i stampuar
BS*	Butoni shtytës NDEZUR/FIKUR, çelësi i operimit

Simboli	Kuptimi
BZ, H*O	Sinjalizuesi
C*	Kondensatori
AC*, CN*, E*, HA*, HE*, HL*, HN*, HR*, MR*_A, MR*_B, S*, U, V, W, X*A, K*R_*, NE	Lidhja, lidhësi
D*, V*D	Dioda
DB*	Ura e diodës
DS*	Çelësi DIP
E*H	Ngrohësi
FU*, F*U, (për karakteristikat referojuni PCB brenda njësisë)	Siguresa
FG*	Lidhësi (baza e kornizës)
H*	Rripi
H*P, LED*, V*L	Llamba e pilotit, dioda që rrezaton dritë
HAP	Dioda që rrezaton dritë (monitori i shërbimit jeshil)
HIGH VOLTAGE	Voltazh i lartë
IES	Sensori inteligjent i syve
IPM*	Modul inteligjent i energjisë
K*R, KCR, KFR, KHuR, K*M	Rele magnetike
L	Me rrymë
L*	Bobinë
L*R	Reaktor
M*	Motori ingranues
M*C	Motori i kompresorit
M*F	Motori i ventilatorit
M*P	Motori i pompës së kullimit
M*S	Motori i lëkundjes
MR*, MRCW*, MRM*, MRN*	Rele magnetike
N	Neutral
NE	Tokëzimi i qetë
n=*, N=*	Numri i kalimeve përmes bërthamës së ferritit
PAM	Rregullimi i gjerësisë së pulsit
PCB*	Qarku i stampuar
PM*	Moduli i energjisë
PS	Ndërrimi i energjisë
PTC*	Termistori PTC

Simboli	Kuptimi
Q*	Tranzitori bipolar me portë të izoluar (IGBT)
Q*C	Çelësi
Q*DI, KLM	Çelësi i rrjedhjes së tokëzimit
Q*L	Protektor mbingarkimi
Q*M	Çelësi termal
Q*R	Pajisja reziduale korrenti
R*	Rezistencë
R*T	Termistor
RC	Marrësi
S*C	Çelësi i kufizimit
S*L	Çelësi i pluskimit
S*NG	Detektori i rrjedhjes së ftohësit
S*NPH	Sensori i presionit (i lartë)
S*NPL	Sensori i presionit (i ulët)
S*PH, HPS*	Çelësi i presionit (i lartë)
S*PL	Çelësi i presionit (i ulët)
S*T	Termostat
S*RH	Sensori i lagështisë
S*W, SW*	Çelësi i operimit
SA*, F1S	Mbrojtës i fryrjes
SR*, WLU	Marrësi i sinjalit
SS*	Çelës i përzgjedhësit
SHEET METAL	Pllaka e fiksuar e rripit terminal
T*R	Transformuesi
TC, TRC	Transmetuesi
V*, R*V	Varistori
V*R	Ura e diodës, tranzitori bipolar me portë të izoluar (IGBT) moduli i energjisë
WRC	Telekomanda uajrles
X*	Terminali
X*M	Rripi i terminalit (blloko)
Y*E	Bobinë valvuli e zgjerimit elektronik
Y*R, Y*S	Bobinë valvuli e solenoidit përmbys
Z*C	Bërthamë ferriti
ZF, Z*F	Filtër zhurme

16 Fjalori

Shitësi
Shpërndarësi i shitjeve për produktin.

Instaluesi i autorizuar
Personi me aftësi teknike, i cili është i kualifikuar për të instaluar produktin.

Përdoruesi
Personi që është zotëruesi i produktit dhe/ose operon produktin.

Legjislacioni në fuqi
Të gjitha direktivat, ligjet, rregullat dhe/ose kodet ndërkombëtare, evropiane, kombëtare dhe vendore, që lidhen dhe përdoren për një produkt ose domen të caktuar.

Kompania e shërbimit
Kompania e kualifikuar që mund të kryejë ose bashkërendojë shërbimin e kërkuar të produktit.

Manuali i instalimit
Manuali i specifikuar i udhëzimit për një produkt ose përdorim të caktuar, duke shpjeguar instalimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen.

Manuali i përdorimit
Manuali i specifikuar i udhëzimit për një produkt ose përdorim të caktuar, duke shpjeguar përdorimin e tij.

Udhëzimet e mirëmbajtjes
Manuali i udhëzimit specifikuar për një produkt të caktuar apo aplikim, i cili sqaron (nëse përshtatet) si të instaloni, konfiguroni, operoni dhe/ose mirëmbani produktin apo aplikimin.

Aksesorë
Etiketa, manuale, fletëudhëzues dhe pajisje, që dorëzohen me produktin dhe që kanë nevojë të instalohen në përputhje me udhëzimet në dokumentet shoqëruese.

Pajisjet opsionale
Pajisje prodhuar ose miratuar nga Daikin që mund të kombinohen me produktin në përputhje me udhëzimet në dokumentet shoqëruese.

Furnizuar nga instaluesi
Pajisje të prodhuara JO nga Daikin që mund të kombinohen me produktin në përputhje me udhëzimet te dokumentacioni shoqërues.

Copyright 2026 Daikin

DAIKIN INDUSTRIES CZECH REPUBLIC s.r.o.
U Nové Hospody 1155/1, 301 00 Plzeň Skvrňany, Czech Republic

DAIKIN EUROPE N.V.
Zandvoordestraat 300, B-8400 Oostende, Belgium

4P847307-1 2026.06